

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5952
E enjte, 12 dhjetor 2019
çmimi 0.40 €

Veseli kthehet nga Haga,
thotë se është krenar me
Kosovën dhe UÇK-në



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", BELUL BEQAJ

LDK-ja S'MUND TË FITOJË PAS ZGJEDHJEVE ATË QË NUK E FITOI NË ZGJEDHJE



Politologu Belul Beqaj ka thënë se Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) nuk mund të fitojë pas zgjedhjeve atë që nuk e ka fituar në zgjedhjet e 6 tetorit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se

kjo parti duhet të lëshojë pe në bisedimet me Lëvizjen Vetëvendosje për arritjen e marrëveshjes për bashkëqeverisje. Beqaj ka vlerësuar se është koha e duhur që LDK-ja të transformohet. Ai ka thënë se 'shtetin

e kapur' nuk mund ta 'shkapin' ata që kanë qenë në periudha të ndryshme pjesë e 'shtetit të kapur'. "Logjikisht nuk duhet në këto dikastere të jenë ata që kanë qenë pjesë të politikave të tilla", ka thënë Beqaj

Presidenti Thaçi thërret seancën konstituive të Kuvendit më 24 dhjetor



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, të mërkurën ka marrë vendim që ta thërrasë mbledhjen e parë të legjislaturës së shtatë të Kuvendit të Kosovës më 24 dhjetor në orën 9:00. Sërish kanë zhvilluar të mërkurën një takim kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti dhe ai i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, por edhe ky takim nuk ka sjellë rezultat pozitiv për arritjen e marrëveshjes për bashkëqeverisje

Sindikalistët takojnë Kurtin, paralajmërojnë greva nëse nuk zbatohet Ligji për paga



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, Viasat, p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

DOSSIER

MULLA NUREDIN MAXHERA, NJË JETË TË TËRË PËR ATDHE E FE



F. 16-17

Prof. dr. Sabile KEÇMEZI-BASHA

AKTUALE



RRITET NUMRI I PERSONAVE TË PREKUR ME KANCER F. 5

GJYKATA SPECIALE FTON EDHE ZAFIR BERISHËN F. 7

NOBELISTI PETER HANDKE SHPALLET PERSON I PADËSHIRUAR NË KOSOVË F. 3

EKONOMI



RRITEN ÇMIMET E MALLRAVE TË KONSUMIT PËR 1.7 PËR QIND F. 9

ATK-ja INKASOI 44 MILIONË EURO MË SHUMË SE NË VITIN E KALUAR F. 9

SPORT

KËRKOHEM QETËSI DHE BASHKIM PARA NDESHJEVE HISTORIKE F. 18

Bushati: 2019 ishte i mbrapshtë, përfshirë zgjedhjet e 30 qershorit

TIRANË, 11 DHJETOR - Ish-ministri i Punëve të Jashtme, Ditmir Bushati, deklaroi se viti 2019 ishte një vit i mbrapshtë dhe shpreson që 2020-ta të jetë vit i reflektimit. Në një intervistë për "Zërin e Amerikës", deputeti socialist tha se edhe zgjedhjet e 30 qershorit ishin "një e keqe" në vitin 2019, ndërsa theksoi se në vitin e ardhshëm duhet ndërtuar një kulturë e re politike, përfshirë mazhorancën që ka peshën më të

madhe të bashkëpunimit. "Ne jemi në fazën e një diskutimi në Kuvend, por në finale ka mbizotëruar një sens më racional duke marrë parasysh propozimet e BE-së dhe OSBE-së. Sepse Shqipëria ka marrë kryesimin e Presidencës së OSBE-së dhe liria e medias është një nga shtyllat kryesore të kësaj organizate. 2019-a ishte një vit i mbrapshtë. Nisi me djegien e mandateve, më pas zgjedhjet e 30 qershorit,

tërmetet që prekën vendin.

Uroj që 2020-a të jetë jo thjesht viti i reflektimit, por edhe bashkëpunimit, për t'i dhënë jetë reformës në drejtësi. Qëllimi i saj nuk ishte thjesht spastrimi i atyre personave të papërshtatshëm për drejtësinë.

Ne duhet të ndërtojmë një proces dhe një kulturë të re politike, ku ne si mazhorancë kemi peshën tonë për ta shtrirë dorën e bashkëpunimit", tha Bushati.



Cooper: Shqipëria, shembull i jashtëzakonshëm për mbështetjen e operacioneve të NATO-s

Zëvendësndihmësja e sekretarit amerikan të Mbrojtjes, Laura Cooper, tha se "Shqipëria është një shembull i jashtëzakonshëm për mbështetjen e operacioneve të NATO-s në të gjitha koalicionet, kohët e fundit në kuadrin e luftës së Gjirit"

TIRANË, 11 DHJETOR - Bashkëpunimi i ShBA-së me vendet e "Kartës së Adriatikut A5" është pjesë e rëndësishme e sigurisë kolektive të Evropës, deklaroi të mërkurën në Tiranë zëvendësndihmësja e sekretarit amerikan të Mbrojtjes, Laura Cooper, në konferencën e ministrave të mbrojtjes të "Kartës së Adriatikut A5". Cooper tha se "Shqipëria është një shembull i jashtëzakonshëm për mbështetjen e operacioneve të NATO-s në të gjitha koalicionet, kohët e fundit në kuadrin e luftës së Gjirit. Angazhimi i ShBA-së për Aleancën e NATO-s ndaj partneriteteve që kemi mbetjet shumë i fortë", ka njoftuar vova. Ajo theksoi se me vendet e A5 gjithmonë ShBA-ja ka sfida të

ndryshme të përbashkëta, ndaj edhe gjatë vitit të kaluar SHBA ka qenë vazhdimisht e pranishme në këtë rajon. "Asistenca e sigurisë së ShBA-së, mbështetja në kuadrin e mbrojtjes vetëm nga Departamenti amerikan i Mbrojtjes për vendet e A5 ka qenë mbi 743 milionë dollarë që nga viti 2012, si pjesë e bashkëpunimit për sigurinë dhe pjesë e ngritjes së kapaciteteve, si për vendet anëtare ashtu edhe për vendet vëzhguese", tha Cooper.

Angazhimi i ShBA-së pasqyron edhe vlerësimin për kontributet e këtyre vendeve në sigurinë globale dhe rajonale, tha ajo. "Shumë prej forcave të armatosura qëndrojnë bashkë në misionet e Afganistanit dhe misionet të tjera. Vendet tuaja



janë të rëndësishme për ofrimin e sigurisë për vendet e rajonit edhe në planin ndërkombëtar", tha Cooper. Ajo theksoi se siguria që ofrojnë vendet e A5 vazhdon të jetë e rëndësishme, madje u përshtatet aspekteve taktike dhe politike të situatave të ndryshme. "Mbështetja e

ShBA-së në kuadrin e dyerve të hapura të NATO-s u jep mundësi vendeve të përzgjedhin rrugën e vet. Nëse ajo është një rrugë e NATO-s apo e BE-së, kjo nuk ndryshon. Ne jemi mbështetës të progresit në rajon. Ne e shikojmë A5 si një mundësi të rëndësishme bashkëpunimi për të

kontribuar në sigurinë kolektive të Evropës", tha Cooper. Në konferencën e Kartës së Adriatikut 5 morën pjesë anëtarët e saj, Shqipëria, Bosnjë e Hercegovina, Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, si dhe vendet vëzhguese Kosova, Sllovenia dhe Serbia.

Basha: Qytetarët duan zgjidhje, jo shfaqje

TIRANË, 11 DHJETOR - Lideri opozitar, Lulzim Basha, rikonfirmoi edhe një herë refuzimin për një tryezë të përbashkët me kryeministrin Rama për situatën e krijuar nga tërmeti. Duke folur për gazetarët ai tha se opozita nuk bëhet pjesë e asnjë shfaqje, teksa përsëriti edhe njëherë se reforma zgjedhore dhe zgjedhjet e parakohshme janë zgjidhja për krizën politike. "Përgjigjen e keni marrë nja 10 herë. Nuk kam asgjë për të shtuar nga ajo që ju kam thënë. Nuk do të bëhemi pjesë e një shfaqje që po na turpëron dhe po shton

dhimbjen dhe vuajtjen e qytetarëve. Dialogu politik për reformën zgjedhore, zhblokimi i dialogut politik për reformën zgjedhore sipas propozimit të shtatorit. Reforma zgjedhore dhe vullneti i qytetarëve përcaktojnë cilësinë e demokracisë dhe jo fotot dhe shfaqjet mes kryetarit të qeverisë dhe kryetarit të opozitës", tha ai.

Për Bashën, me apo pa tryeza, është detyrë e qeverisë t'i ndihmojë njerëzit në nevojë. "26 nëntori ishte një fatkeqësi natyrore por tregoi qartë se sa i keqpërgatitur është shteti shqip-

tar për t'iu përgjigjur një fatkeqësie të tillë. Insistoj që të kalohet nga fjalët dhe shfaqjet në vepra që janë detyrë e qeverisë. Qeveria e ka për detyrë të ndihmojë njerëzit në nevojë, të përfundojë vlerësimin e banesave", tha ai. Deklaratën Basha e bëri pas takimit që pati me ministrin e Jashtëm të Italisë, të cilin e falënderoi edhe njëherë për mbështetjen dhënë Shqipërisë në operacionin e kërkim-shpëtimit. "Faza e dytë e emergjencës po godet mijëra familje shqiptare të pastreha. Italianët ishin të parët, ardhja e tyre me eksper-



tizën e duhur ndihmuan në shpëtimin e dhjetëra jetëve. E falënderova për avokatin e palodhshëm që po bën për negociatat. Diskutuam për

krizën dhe vendosmërinë e opozitës për të dhënë kontributin e saj, reformën zgjedhore dhe zgjedhje të parakohshme", tha Basha.

Presidenti Thaçi thërret seancën konstituive të Kuvendit më 24 dhjetor



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka marrë vendim të mërkurën që ta thërrasë mbledhjen e parë të legjislaturës së shtatë të Kuvendit të Kosovës më 24 dhjetor, në orën 9:00. Sërish kanë zhvilluar të mërkurën një takim kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti dhe ai i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, por edhe ky takim nuk ka sjellë rezultat pozitiv për arritjen e marrëveshjes për bashkëqeverisje

**EPOKA
ERE****Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 11 DHJETOR - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, duke u thirrur në kompetencat kushtetuese, ka thirrur seancën konstituive të Kuvendit të Kosovës për datën 24 dhjetor. Në një komunikatë për media të Zyrës së Presidentit, thuhet se "presidenti ka nxjerrë vendimin për thirrjen e mbledhjes së parë të legjislaturës së shtatë të Kosovës, e cila do të mbahet më 24 dhjetor 2019, duke filluar nga

ora 9:00".

Kryetari dhe kryesia e legjislaturës së gjashtë të Kuvendit të Kosovës, në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi, do ta përgatisin propozimin e rendit të ditës për mbledhjen e parë të përbërjes së re të Kuvendit. Të mërkurën janë takuar sërish lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti dhe ai i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa.

Lëvizja Vetëvendosje përmes një njoftimi për media ka bërë me dije se takimet mes dy liderëve

do të vazhdojnë deri në arritjen e marrëveshjes. "Kryetari Kurti u takua sot në Kuvendin e Kosovës me kryetarin Mustafa. Ata do t'i vazhdojnë dhe shtojnë takimet pothuajse për çdo ditë deri në arritjen e marrëveshjes", është thënë në njoftimin e Lëvizjes Vetëvendosje. Marrëveshja për koalicionin e ardhshëm qeverisës ndërmjet Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) ka hasur në bllokadë pasi që LDK-ja po dëshiron ta përfshijë në këtë marrëveshje edhe

postin e presidentit të Kosovës, i cili, sipas mandatit kushtetues, duhet të zgjedhet në pranverën e vitit 2021. Për këtë gjë nuk po pajtohet Lëvizja Vetëvendosje e cila po e konsideron të padiskutueshëm postin e presidentit. Ndërkaq njohësit e proceseve politike në vend kanë thënë se LV-ja dhe LDK-ja duhet t'i ulin tensionet dhe të veprojnë me përgjegjshmëri ndaj popullit për krijimin e qeverisë.

Thirrje për formimin e shpejtë të institucioneve të reja kanë bërë ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Philip Kosnett, ai i Britanisë, Nicholas Abbott, ambasadori gjerman Christian Heldt dhe shefja e Zyrës e Bashkimit Evropian në Kosovë, Nataliya Apostolova.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka certifikuar më 27 nëntor rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të parakohshme par-

lamentare të mbajtura më 6 tetor.

Bazuar në numrin e votave të fituara, Lëvizja Vetëvendosje do të ketë 29 deputetë në Kuvendin e Kosovës, LDK-ja 28, PDK-ja 24 deputetë, koalicioni AAK-PSD 13, Nisma Socialdemokrate, Aleanca Kosova e Re dhe Partia e Drejtësisë 6 deputetë. Ndërkaq, nga komunitetet joshumicë, Lista Serbe 10 deputetë, si dhe 10 vende kanë fituar së bashku të gjitha partitë e minoriteteve joserbe. Kuvendi i Kosovës ka 120 ulëse, prej tyre 20 ulëse janë të garantuara për komunitetet joshumicë, përkatësisht 10 për komunitetin serb dhe po aq për komunitetet e tjera joshumicë. Neni 66 i Kushtetutës së Kosovës e parasheh mënyrën e konstituimit të Kuvendit. Aty përcaktohet se Kuvendi zgjidhet me mandat katërvjeçar, duke filluar nga dita e seancës konstituive.

Nobelisti Peter Handke shpallet person i padëshiruar në Kosovë



PRISHTINË, 11 DHJETOR - Shkrimtari dhe laureati i Çmimit Nobel për Letërsi, Peter Handke, është shpallur person i padëshiruar ("persona non grata") në Kosovë. Këtë e ka konfirmuar, nëpërmjet një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", ministri i Jashtëm në detyrë i Kosovës, Behgjet Pacolli. "Sot kam vendosur ta shpall Peter Handke 'persona non grata' në Kosovë për shkak të mbështetjes që ai i dha Millosheviçit dhe politikave të tij gjenocidale në Kosovë dhe Bosnje e Hercegovinë dhe për mohimin e gjenocidit të kryer nga Serbia. Ai dhe Komiteti i

Nobelit treguan mosrespekt ndaj viktimave të gjenocidit", ka shkruar Pacolli.

Ndarja e Çmimit Nobel për shkrimtarin Handke ka shkakuar zemërim në Ballkan dhe më gjerë për shkak se ai kishte mbështetur zëshëm ish-presidentin serb, Sllobodan Millosheviq, gjatë luftërave në ish-Jugosllavi në vitet 1990.

Turqia, Kroacia, Kosova, Shqipëria dhe Bosnje e Hercegovina e anuluan pjesëmarrjen në ceremoninë e ndarjes së çmimit Nobel në Stokholm të Suedisë më 10 dhjetor.

Flet për "Epokën e re", Belul Beqaj

LDK-ja s'mund të fitojë pas zgjedh



Politologu Belul Beqaj ka thënë se Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) nuk mund të fitojë pas zgjedhjeve atë që nuk e ka fituar në zgjedhjet e 6 tetorit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se kjo parti duhet të lëshojë pe në bisedimet me Lëvizjen Vetëvendosje për arritjen e marrëveshjes për bashkëqeverisje. Beqaj ka vlerësuar se është koha e duhur që LDK-ja të transformohet. Ai ka thënë se 'shtetin e kapur' nuk mund ta 'shkapin' ata që kanë qenë në periudha të ndryshme pjesë e 'shtetit të kapur'. "Logjikisht nuk duhet në këto dikastere të jenë ata që kanë qenë pjesë të politikave të tilla", ka thënë Beqaj

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 11 DHJETOR - Politologu Belul Beqaj ka bërë me dije se Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) duhet të lëshojë pe për marrëveshjen për bashkëqeverisje me Lëvizjen Vetëvendosje (LV). Ai ka thënë se kjo parti nuk mund të fitojë pas zgjedhjeve atë që nuk e ka fituar në zgjedhje. Në këtë intervistë dhënë për gazetën

"Epoka e re", Beqaj ka thënë se liderishipi i kësaj partie po përpiqet ta nxjerrë maksimumin nga këto negociata. "Paralajmërimet para dhe gjatë fushatës, se LDK-ja është 'e para dhe partia më e madhe', nuk u dëshmuar pas zgjedhjeve. Përkundrazi, u vërtetua se kjo parti është 'tigër prej letre'. Në një situatë të tillë liderishipi i saj po mundohet me tyxharllëk klasik të logjikës së tejkaluar të fitojë pas zgjedhjeve atë që nuk

Agjencia e Kosovës për Forenzikë dhe Instituti i Mjekësisë Ligjore arrijnë marrëveshje bashkëpunimi



PRISHTINË, 11 DHJETOR (ER) - Agjencia e Kosovës për Forenzikë dhe Instituti i Mjekësisë Ligjore kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi në fushën e forenzikës. Kjo marrëveshje bashkëpunimi ka për qëllim rritjen e bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë së Kosovës për Forenzikë dhe Institutit të Mjekësisë Ligjore për rritjen dhe forcimin e kapaciteteve njerë-

zore, teknike dhe profesionalizimin në zbatimin e shkencave mjeko-ligjore (forenzike) si dhe shkëmbimin e përvojave me të mira dhe informacioneve që ndikojnë në efikasitetin e procedimit të rasteve. Kryeshefi ekzekutiv i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, dr. Blerim Olluri dhe drejtori i përgjithshëm i Institutit të Mjekësisë Ligjore, dr. Arsim

Gerxhaliu, me rastin e nënshkrimit, u zotuan se ky bashkëpunim do të rritet vazhdimisht, duke lehtësuar procedurat e shkëmbimit të informacioneve dhe duke përkrahur njëra-tjetrën në çdo aspekt, me të vetmin qëllim: ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe shkencore të dy institucioneve në fushën e forenzikës.

Beqaj: Nuk e fitoi në zgjedhje

kapur'. Prandaj, logjikisht nuk duhet në këto dikastere të jenë ata që kanë qenë pjesë e politikave të tilla", ka thënë Beqaj.

"Epoka e re": Z. Beqaj, ndonëse është pritur se marrëveshja për bashkëqeverisje në mes të LV-së dhe LDK-së do të ndodhë shpejt, ende nuk ka diçka konkrete. Pse mendoni se po ndodh kjo zvarritje?

Beqaj: Paralajmërimet para dhe gjatë fushatës, se LDK-ja është 'e para dhe partia më e madhe', nuk u dëshmuar pas zgjedhjeve. Përkundrazi, u vërtetua se kjo parti është 'tigër prej letre'. Në një situatë të tillë lidhshipi i saj po përpigjet me tyxharllëk klasik të logjikës së tejkualuar të fitojë pas zgjedhjeve atë që nuk e fitoi në zgjedhje!

"Epoka e re": Zyrtarët e LDK-së me këmbëngulje pretendojnë se në marrëveshje duhet të përfshihet edhe posti i presidentit, gjë që e kundërshton LV-ja. Si e keni parë këtë insistim të LDK-së në këtë post?

Beqaj: LDK-ja s'po kupton se sovranitë ka filluar ta ndaj 'shapin prej sheqerit'. Zgjedhësit deri në këto zgjedhje janë frikësuar nga ndryshimi, ndërsa tashti janë të sigurt se mosndryshimi është më i rrezikshëm se ndryshimi. Është koha e duhur që LDK-ja të transformohet në drejtim të vetëdijes politike të sovranit.

"Epoka e re": Në anën tjetër, zyrtarët e LV-së insistojnë se patjetër duhet ta udhëheqin Ministrinë e Punëve të Brendshme të cilën po e kërkon edhe LDK-ja. E shihni si të mundshëm ndonjë kompromis në mes të postit të presidentit dhe MPB-së?

Beqaj: Kompromisi është bërë me faktin se ministri, zëvendësministër e ka përfaqësuesin e partisë tjetër. Logjikisht 'shtetin e kapur' nuk mund ta 'shkapin' ata që kanë qenë në periudha të ndryshme pjesë e 'shtetit të kapur'. Prandaj, logjikisht nuk duhet në këto dikastere të jenë ata që kanë qenë pjesë të politikave të tilla.

"Epoka e re": Në bazë të asaj që kemi parë deri më tani, a pritni një marrëveshje të shpejtë në mes të këtyre dy subjekteve?

Beqaj: Mosmarrëveshja në mes tyre mund të zgjasë pafundësisht nëse brenda LDK-së nuk këndellën se ata nuk mund të fituar me tyxharllëk atë që e kanë humbur në zgjedhje. Sovranitë ka votuar për ndryshim, ata po përpigjen të rikthjenë logjikën e shtetit të kapur me të cilën kanë bashkëqeverisur me partitë që nxitën pakënaqësinë

dhe ndryshimin nga sovranitë! Isa Mustafa dhe logjika e poltronëve rreth tij nuk simbolizojnë ndryshimin, përkundrazi ata e përkujtojnë shtetin e kapur.

"Epoka e re": Nëse nuk ndodh kjo marrëveshje, cila do të ishte alternativa: zgjedhje të reja apo LV-ja të hapet ndaj partive të

tjera?

Beqaj: Nëse nuk ndodh kjo marrëveshje, nuk ka nevojë të lëshojë pe asnjëra parti. LDK-ja duhet, në interes të së ardhmes së vet, të kuptojë se nuk i takon diçka që rikthen në mendje qytetarin, shtetin e kapur. LDK-ja duhet të kuptojë se vizioni i saj që e bën faktor të besueshëm në të ardhmen, ndërlihet me

reforma të thella kadrovike të cilat racionalisht e rishikojnë 'konceptin e institucionalizmit' në favor të njerëzve që vendosen në institucione. Ndërsa LV-ja duhet të kuptojë së politikëbërja 'sovrane' më shumë varet nga shtetet pa të cilat nuk do të ishte krijuar shteti i Kosovës sesa nga dëshira dhe përkushtimi i LV-së për politika sovraane.

Rritet numri i personave të prekur me kancer



PRISHTINË, 11 DHJETOR - Blerina K., 47-vjeçare, do të udhëtojë drejt Kroacisë, përkatësisht në Zagreb, për ta marrë trajtimin mjekësor për sëmundjen e kancerit. Arsyeja pse ajo po udhëton atje është se në Kosovë nuk mund të marrë brahiterapinë (aparatura e brahiterapisë shërben për kryerjen e rrezatimeve të tumoreve gjinekologjike). Përkundër asaj se brahiterapia nuk aplikohet në Institutin Onkologjik, Blerina nuk ka pasur mundësi të marrë as konfirmim nga ana e mjekëve, në mënyrë që të përfitojë nga fondi për trajtim jashtë institucioneve publike shëndetësore, me arsyetimin se vitin e ardhshëm kjo lloj terapie do të nisë së zbatuari në Kosovë. "Unë nuk kam kohë të pres deri vitin e ardhshëm meqë e kam diagnozën e tillë. Brahiterapia nuk aplikohet në Kosovë. Kjo është edhe arsyeja që kam vendosur të shkoj në klinikën e Zagrebit. Këtu kanë thënë se deri vitin e ardhshëm nuk aplikohet terapia që unë duhet ta marr. Njëkohësisht nuk e kanë lëshuar as dokumentin që unë kam nevojë të trajtohem jashtë. Kjo besoj lidhet me mjetet që Ministria e Shëndetësisë do të duhej t'i lëshonte për shkak se trajtimi nuk bëhet këtu, por jashtë shtetit. Dhe si familje kemi

vendosur të shkojmë me mjete vetjake, e që ende nuk e di as sa kushton", ka thënë ajo. Numri i të prekurve me kancer këtë vit në Kosovë është rritur. Ilir Kurtishi, drejtor i Institutit Onkologjik në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, thotë se ky vit pritet të përmbyllet me 1 600 raste të reja me kancer. Ai shton se brahiterpia do të fillojë të aplikohet te pacientët gjatë vitit të ardhshëm. Ndërkaq edhe imunoterapia, siç thotë ai, këtë vit ka hyrë në listën esenciale, por për një numër të caktuar të pacientëve. Në Institutin Onkologjik frekuenca ditore e pacientëve është rreth 250 persona. Sipas Kurtishit, rreth 150 persona marrin kimioterapi dhe 100 të tjerë radioterapi, trajtime këto që i ofron Instituti Onkologjik. Ndarë në gjini, kanceri i gjirit prin te femrat, derisa ai i mushkërive te meshkujt. Kurtishi thotë se me gjithë mangësitë, kushtet e trajtimit në këtë Institut nuk janë të këqija. "Furnizimi gjatë gjithë vitit ka qenë në rregull, me disa mungesa të vogla. Por, aktualisht në klinikë te ne jemi të furnizuar mirë. Kushtet e trajtimit janë të mira. Këtë vit kemi pasur shërbim 24 orësh", ka thënë Kurtishi. Sipas tij, një nga vështirësitë rreth funksionimit të kësaj klinike është edhe

mungesa e stafit. "Vështirësitë që jemi përballur gjatë këtij viti kanë qenë numri më i madh apo shtimi i rasteve me kancer si dhe hapësirat e mangëta në Institutin Onkologjik. Vlen të theksohet se kemi mungesë të stafit, me theks të veçantë të stafit të mesëm, apo infermierëve", ka thënë ai. Në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, zëdhënësi Shpend Fazliu tha se mungesa e stafit në këtë institucion është e evidente, ndonëse gjatë këtij viti ka pasur më shumë se 100 infermierë të punësuar. "Qendra Klinike Universitare e Kosovës ka pasur konkurs për 100 infermierë dhe e ka zbutur pak nevojën e stafit të mesëm, por ende ka nevojë për të në çdo klinikë apo në shumicën prej tyre. Shpresojmë se gjatë vitit 2020 buxheti i QKUK-së do të lejojë punësimin e më shumë infermierëve jo vetëm për Klinikën e Onkologjisë, që e ka numrin më të madh të pacientëve kohët e fundit, por edhe në klinikat e tjera", ka thënë Fazliu. Gjatë vitit 2018 janë shënuar 1 500 raste të reja me kancer, ndërkaq llojet e kancerit që kanë dominuar kanë qenë: kanceri i gjirit te femrat, kanceri i mushkërive te meshkujt dhe kanceri i zorrës së trashë i cili prek më shpesh meshkujt sesa femrat.

e fitoi në zgjedhje", ka thënë Beqaj.

Ai ka theksuar se tani është koha e duhur që LDK-ja të transformohet. Sipas Beqajt, sovranitë ka filluar ta ndaj "shapin prej sheqerit". Zgjedhësit deri në këto zgjedhje janë frikësuar nga ndryshimi, ndërsa tashti janë të sigurt se mosndryshimi është më i rrezikshëm se ndryshimi! Është koha e duhur që LDK-ja të transformohet në drejtim të vetëdijes politike të sovranit", është shprehur Beqaj.

Ai ka folur edhe për mospajtimet e këtyre dy subjekteve për Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Ai ka thënë se 'shteti i kapur' nuk mund të shkapet nga ata që kanë kontribuar në këtë drejtim. "Kompromisi është bërë me faktin se ministri, zëvendësministër e ka përfaqësuesin e partisë tjetër. Logjikisht 'shtetin e kapur' nuk mund ta 'shkapin' ata që kanë qenë në periudha të ndryshme pjesë e 'shtetit të

Mbahet trajnim simulues për mbrojtje nga tërmetet

MITROVICË, 11 DHJETOR (ER) - Drejtori i Arsimit, Egzon Jashari, së bashku me zyrtarë komunalë nga kjo drejtori, të mërkurën kanë ndjekur për së afërmi demonstrimin e planit të evakuimit në Gjimnazin "Frang Bardhi", që kishte për qëllim t'i përgatiste nxënësit se si të veprojnë në raste të tërmeteve. Në këtë aktivitet ishte e pranishme edhe drejtoresha e kësaj shkolle, Zybede Gigolli Latifi, mësimit, nxënës, zyrtarë

policorë, zjarrfikës si dhe stafi mjekësor nga QKMF-ja. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte ngritja e gatishmërisë dhe zvogëlimi të rrezikut nga tërmetet në shkollë, me ç'rast u realizua duke bërë evakuimin e nxënësve nga shkolla në oborr dhe trajtimin e atyre nxënësve që kanë mbetur brenda objektit shkollor. Me këtë rast, drejtori Jashari ka përgëzuar personelin e kësaj shkolle për këtë organizim, duke thënë se aktivitetet të tilla

janë shumë të rëndësishme dhe të domosdoshme, duke pasur parasysh ngjarjet e fundit në vendet përreth. "Mendoj se ky demonstrim i këtij plani sot paraqet një dëshmi praktike shumë të nevojshme se si duhet të veprohet në raste të fatkeqësive natyrore. Dukuri të tilla janë të paparashikueshme dhe ky veprim sot sadopak jep mesazh solidarizues me rastin e fundit që ka ndodhur në Shqipëri", ka thënë drejtori Jashari.



Institucioni i Avokatit të Popullit lansoi Platformën për të Drejtat e Njeriut

EPOKA E ENJTE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 11 DHJETOR - Institucioni i Avokatit të Popullit me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, ka publikuar për të gjithë qytetarët e vendit Platformën për të Drejtat e Njeriut e cila synon ta promovojë zbatimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, siç garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, aktet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe me ligjet e zbatuara në Kosovë. Platforma për të Drejtat e Njeriut

është projektuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit dhe është zhvilluar në bashkëpunim me Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) me mbështetje financiare të Ministrisë së Punëve të Jashtme Norvegjeze.

Platforma ofron dy udhëzues: "Udhëzuesin e të Drejtave të Njeriut" dhe "Udhëzuesin e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZHQ) në lidhje me të drejtat e njeriut, të cilët do të shërbejnë për të siguruar qasje më të lehtë dhe praktike në juridiksionin vendor dhe ndërkombëtar përmes lidhjeve

të strukturuar në mes të instrumenteve juridike të cilat zbatohen drejtpërdrejt në sistemin juridik të Republikës së Kosovës si dhe për t'i demonstruar lidhjet e objektivave për zhvillim të qëndrueshëm me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Platforma ofron informacion të dobishëm për të gjitha subjektet e së drejtës, përfshirë qytetarët, praktikuesit e ligjit, gjyqtarët, prokurorët, institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut, institucionet arsimore, organizatat e shoqërisë civile, bizneset, studentët dhe të gjithë të interesuarit.



Takohet grupi punues për zbatimin e Strategjisë kundër terrorizmit



PRISHTINË, 11 DHJETOR (ER) - Në Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) të mërkurën është mbajtur takimi i grupit për zbatimin e strategjisë dhe planit të veprimit kundër terrorizmit, ku është bërë raportimi i aktiviteteve të zbatuara në kuadër të strategjisë. Takimin e hapi ministri në detyrë i Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, i cili, pasi falënderoi anëtarët e grupit për punën, bëri një përmbledhje të punës së institucioneve në angazhimet konkrete për luftimin e kësaj dukurie globale, ku ka qenë e përfshirë edhe Republika e Kosovës. Ministri Mustafa vuri në dukje

angazhimin që ka pasur shteti i Kosovës në kuadër të luftës globale kundër terrorizmit, sidomos në parandalimin e qytetarëve të Kosovës që t'u bashkëngjiten luftërave të huaja. Në kuadër të angazhimeve aktuale, Mustafa ka theksuar angazhimin sa i përket kthimit të qytetarëve të Kosovës nga lufta në Siri. Ai ka bërë me dije se i kanë përfshirë në programe këta qytetarë të kthyer për risocializim të tyre në shoqërinë tonë. Në këtë takim u raportuan të gjitha aktivitetet që janë realizuar në kuadër të planit të veprimit të kësaj strategjie dhe ato që ka pasur vështirësi në zbatim.

IPK-ja, pjesë e konferencës ndërkombëtare të antikorrupsionit

PRISHTINË, 11 DHJETOR (ER) - Kryeshefja e Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK), Miradije Kelmendi, me bashkëpunëtorë, po merr pjesë në konferencën vjetore të radhës të EPAC-ut (European Partners Against Corruption - Partnerët Evropianë Kundër Korrupsionit) dhe Asamblesë së Përgjithshme e

cila po mbahet në Stokholm të Suedisë. Në këtë konferencë po marrin pjesë 33 delegacione të institucioneve të mbikëqyrjes policore dhe agjencive kundër korrupsionit nga shtetet evropiane, si dhe përfaqësues nga EUROPOL-i, OLAF dhe organizatat të tjera ndërkombëtare dhe rajonale. Në kuadër të punimeve

në konferencë po diskutohen dhe trajtohen tema të rëndësishme që kanë të bëjnë me fuqizimin e luftës kundër korrupsionit, fuqizimin e integritetit të zyrtarëve dhe rolin e sinjalizuesve në luftimin e korrupsionit. Në kuadër të agjendës së parapare do të mbahen punëtori të ndryshme që, mes të tjerash, do

të trajtojnë tema si konflikti i interesit dhe integritetit në fushën e policisë, sfidat dhe rreziqet e reja në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit etj. Përfaqësuesit e delegacionit të Kosovës në këtë konferencë po zhvillojnë takime të ndara me shumicën e delegacioneve pjesëmarrëse nga shtetet e



Evropës me qëllim të njohjes dhe shkëmbimit të praktikave të mira për forcimin e sundimit të ligjit.

Gjykata Speciale fton edhe Zafir Berishën

PRISHTINË, 11 DHJETOR (ER) - Ish-deputeti i Nismës Socialdemokrate, Zafir Berisha, është ftuar për intervistim nga Gjykata Speciale. Lajmin e ka bërë me dije Berisha në llogarinë e vet në "Facebook". "As padrejtësitë e radhës nuk do ta

zbehin luftën dhe përpjekjen e UÇK-së për liri. Ftesa nga Gjykata Speciale në Hagë po shpresoj se është përpjekja e fundit për ta njoollur luftën dhe sakrificën shekullore të shqiptarëve për liri në trojet e veta. Tendencë për ta krahasuar

luftën çlirimtare të UÇK-së me luftën gjenocidale të Serbisë nga kjo gjykatë e cila është produkt i një 'raporti' me të dhëna nga Serbia dhe mbetjet e tyre në Kosovë, është ofendim për mijëra qytetarë të vrarë nga aparati shtetëror i Serbisë. (Më

në fund, dikush po i korrë 'frutet' e luftës speciale 20-vjeçare kundër vlerave të UÇK-së dhe eksponentëve të saj)! Për dy dekada është heshtur përballë një fushate të orkestruar kundër luftës, luftëtarëve (UÇK-së) dhe veprimtarëve të



çështjes kombëtare", ka shkruar Berisha.

Veseli kthehet nga Haga, thotë se është krenar me Kosovën dhe UÇK-në

Pas kthimit nga Haga, ku ishte ftuar për intervistim nga Gjykata Speciale, kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka thënë se do të jetë çdoherë krenar me Kosovën dhe luftën e UÇK-së. Në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" kishin dalë qytetarë të shumtë për ta pritur Veselin, i cili ka qenë ndër themeluesit e UÇK-së



EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 DHJETOR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, është kthyer të mërkurën nga Haga, pas intervistimit nga Gjykata Speciale. Për ta mirëpritur Veselin në Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari" kishin dalë shumë qytetarë. Dhjetëra të rinj kishin veshur edhe fanella të bardha me mbishkrime. "Unë jam Kadri Veseli, luftëtar, krenar. Sa më shumë paqe dhe qetësi për popullin tonë. Zoti e mbrojt Kosovën! Lavdi e përjetshme Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës! Gjithmonë krenar, përjetë!", ka thënë Veseli në një prononcim të shkurtër për medie.

Më pas, nëpërmjet një postimi në profilin e vet në "Facebook",

ai i ka falënderuar të gjithë qytetarët që kishin dalë ta prisnin në aeroport. "Faleminderit të gjithëve për pritjen! Gjithmonë krenar me Kosovën dhe lavdi e përjetshme Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës!", ka shkruar lideri i PDK-së.

Veseli, i cili ka qenë ndër themeluesit e UÇK-së, pas intervistimit nga Gjykata Speciale ka deklaruar se lufta e UÇK-së ka qenë përballje me spastrimin etnik të Serbisë në Kosovë. "Siç edhe kam premtuar publikisht, sot jam paraqitur për intervistim. E kam përfunduar intervistën. Vitet '90 kanë qenë të rënda për popullin tonë, nënshtrim para Serbisë për spastrim etnik për gjenocid kundër popullit tonë", pati thënë Veseli.

Veseli, i cili ka qenë pjesë e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-

së, nuk ka treguar se në çfarë cilësie është intervistuar nga prokurorët në Hagë.

Dhomat e Specializuara deri më tani kanë ftuar mbi 100 persona për intervistim, ndër ta edhe disa nga ish-figurat e larta të UÇK-së që pas luftës ishin dhe janë pjesë

e skenës politike të Kosovës. Në mesin e tyre: Rustem Mustafa, Sami Lushtaku, Shukri Buja dhe Ramush Haradinaj. Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorisë Speciale janë përgjegjëse për hetimin e krimeve kundër njerëzimit,

krimeve të luftës dhe krimeve të tjera penale që lidhen me akuzat e ngritura në një raport të Këshillit të Evropës më 2011. Në këtë raport flitet për krime të prentuara të ish-pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në periudhën e viteve 1998-2000.

Edita Tahiri, Vuçiqit: Të paska marrë malli për NATO-n



PRISHTINË, 11 DHJETOR (ER) - Ish-ministrja për Dialog, Edita Tahiri, nëpërmjet një postimi të publikuar në llogarinë e vet në "Facebook", ka reaguar rreth deklaratave të fundit të presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, i

cili masakrën e Reçakut e quajti trillim. Tahiri ka treguar edhe për një komunikim që ka pasur me Vuçiqin gjatë procesit të dialogut kur, sipas saj, Vuçiqi ishte shfaqur si agresor dhe kërcënues. "Vuçiqi i Serbisë rishfaq mendësinë

kriminale duke mohuar gjenocidin në Kosovë. Sot ai vë në dilemë kufijtë e shtetit të Kosovës, ndërsa e di mirë se Gjykata Ndërkombëtare për Drejtësi njohu ligjërisht kufijtë dhe shtetin e Kosovës. Njëherë

gjatë dialogut në Bruksel Vuçiqi u shfaq si agresor dhe kërcënues. I pata thënë 'të paska marrë malli për NATO-n. Ju jeni mësuar ta shkelni të drejtën ndërkombëtare'. Këtë po ia them edhe sot", ka shkruar Edita Tahiri.

Hoxhiq: Përfshirja e grave në institucionet lokale nuk është në nivelin e duhur

PRISHTINË, 11 DHJETOR (ER) - Në një takim të iniciuar nga MAPL-ja, në krye me ministren Adrijana Hoxhiq e në bashkëpunim me OSBE-në, temë e diskutimit të mërkurën ishte përfaqësimi gjinor në nivelin lokal dy vjet pas zgjedhjeve lokale. Në takim morën pjesë përfaqë-

sues të vetëqeverisjeve lokale, institucioneve të tjera qeveritare, përfaqësues të sektorit joqeveritar lokal si dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare. "Në dy vjetët e kaluar është regjistruar përparim i përfshirjes së grave në institucionet lokale, por qëndron fakti se ky parim nuk ka arritur nivelin e

duhur. Është e domosdoshme që të zbatohen plotësisht të gjitha ligjet dhe mekanizmat institucionale në luftën kundër diskriminimit dhe marginalizimit të grave në të gjitha sferat e jetës dhe proceset që ndodhin në shoqërinë tonë", ka thënë ministrja Hoxhiq.



ATK-ja inkasoi 44 milionë euro më shumë se në vitin e kaluar

Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) gjatë vitit 2019 ka rritur inkasimin e të hyrave për 44 milionë euro nga mbledhja e borxheve në krahasim me vitin e kaluar. Sipas drejtorit të ATK-së, Ilir Murtezaj, të hyrat në ATK arrijnë shumën e inkasimit afër 500 milionë euro



EPOKA E ENJTE
Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 11 DHJETOR - Drejtori i përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Ilir Murtezaj, në një konferencë për medie ka prezantuar të mërkurën rezultatet e aktiviteteve për konfiskimin e pasurisë së tatimpaguesve borxhlinj. Murtezaj ka deklaruar se gjatë vitit 2019 është rritur për 44 milionë euro mbledhja e borxheve në krahasim me vitin e kaluar. Sipas tij, të hyrat në ATK arrijnë shumën e inkasimit afër 500 milionë euro. "ATK-ja ka inkasuar 465.7 milionë euro, 44 milionë më tepër se në vitin e kaluar. Këto janë arritur krahas punës së madhe të ATK-së. ATK-ja ka arritur fuqishëm performancën. Mbledhja e borxheve është indikator që në të kaluarën është akuzuar për performancë negative. Këtë vit, si rezultat i llogaridhënies, është arritur që për herë të parë të shënohet rritje e trendit. 355 milionë euro janë borxhe në këtë vit, pra 20 milionë euro kemi borxhe më pak. 42 për qind ka qenë efikasiteti i kthimit të borxheve", u shpreh ai. Megjithatë, Murtezaj ka thënë se janë të pakënaqshëm, por që do t'i vazhdojnë përpjek-

jet për ta rritur edhe më shumë performancën e të hyrave. "Nuk janë të kënaqshme, por na inkurajojnë për mbledhjen e borxheve. Është përgjegjësi për të gjithë zyrtarët tatimorë, që krahas rritjes së buxhetit, inkasojmë të drejtat e barabarta. Duhet ta shfrytëzojmë këtë vendimarrje të qeverisë që të jemi më të fuqishëm në këtë drejtim e mos të kemi vjetërsim të borxheve", ka deklaruar ai. Murtezaj më tutje ka thënë se deri në vitin 2021 do të realizohen 17 reforma në fusha të ndryshme në mbledhjen e borxheve. "Në vitet 2019-2021 është paraparë që të realizohen mbi 27 reforma në 10 fusha. Konsolidimi i mbledhjes së detyrueshme. Të bëhet shpërndarja e barabartë e punëve të zyrtarëve, të arrihet efikasiteti i mbledhjes. 250 konfiskime gjatë këtij viti, që është numër rekord. Nuk kemi dallime në sektor. Bëhet konfiskimi në të gjithë sektorët, trajtohet njësoj qoftë biznes i madh apo i vogël", është shprehur Murtezaj. Kurse zëvendës-drejtori Nijazi Asllani ka thënë se llogaridhënia dhe përgjegjësia nga ana e ATK-së do ta mundësojë që edhe tatimpaguesit t'i përfundojnë obligimet e tyre. "Veprim korrekt dhe të barabartë të

tatimpaguesve. Përveç shërbimeve, edhe veprimet tona ndaj atyre që vazhdojnë të mos jenë korrekt në punën e tyre", u shpreh ai. Asllani ka njoftuar se tatimpaguesit kanë filluar t'i kryejnë obligimet e tyre me këste, andaj

thotë ai se rezultatet janë konkrete dhe të prekshme krahasuar me vitet e kaluara. "Nëse ne rrisim llogaridhënien dhe seriozitetin, edhe ata do t'i kryejnë detyrimet e veta tatimore. Kemi rezultate konkrete dhe të prekshme. 73 milionë

është si rezultat i marrëveshjeve me tatimpaguesit për kryerjen e detyrimeve të tyre me këste. 119 për qind më shumë se në vitin 2018. Këto rezultate na inkurajojnë që tatimpaguesit kanë filluar përfundimin e detyrimeve të tyre", u shpreh ai.

Gjermania mbështet aftësimin profesional në Ballkanin Perëndimor



PRISHTINË, 11 DHJETOR (ER) - Është nënshkruar marrëveshja mes Forumit të Dhomës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor dhe Bankës Gjermane për Zhvillim. Nënshkrimi i marrëveshjes është organizuar të mërkurën nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë së Malit të Zi, e që u realizua në mes të Forumit të Investimeve të Dhomave të Ballkanit Perëndimor dhe Bankës Gjermane të Zhvillimit përmes Fondit Rajonal të Sfidave, i cili jep fonde të aprovuara nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim. Projekti ka për qëllim zhvillimin e arsimit profesional përmes të

cilit do të ofrohen ekspertiza për profesionalizimin e fuqisë së punës për nevojat e tregut të punës. Zëvendëskryeministri i Malit të Zi, Milutin Simoviç, falënderoi Bankën Gjermane dhe Ministrinë Federale Gjermane për fondet e ofruara për aftësimin profesional të fuqisë punëtore në Ballkanin Perëndimor dhe promovimin e ideve inovatore. Ai, po ashtu, foli për domosdoshmërinë e bashkëpunimit rajonal në nivelin politik, ekonomik dhe të sigurisë por, siç tha ai, bashkëpunimi në këto nivele nuk është aspak i mundur pa avancimin e arsimit dhe aftësimin të rinjve dhe stafit profesional.

Sindikalistët takojnë Kurtin, paralajmërojnë greva nëse nuk zbatohet Ligji për paga

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 11 DHJETOR - Përfaqësuesit e Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, të Shkencës dhe të Kulturës, të Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës dhe të Sindikatës së Policisë së Kosovës janë takuar të mërkurën me kryetarin e Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti.

Tre drejtuesit sindikalistë thanë se pas dërgimit në Kushtetuese të Ligjit për paga, gjendja është alarmante, teksa nuk i mohuan grevat e përgjithshme. Ata i bënë thirrje Gjykatës Kushtetuese që të marrë vendim të drejtë dhe mos ta pezullojë Ligjin për paga, por vetëm të bëhen ndryshime në ata sektorë ku ka pakënaqësi. Veç kësaj, përfaqësuesit e sindikatave thanë se janë në një pozitë të pafavorshme, pasi ende s'ka formim të qeverisë dhe gjykata ende nuk ka marrë vendim. "Lusim palët e interesit që mos të bëjnë presion mediatik në Gjykatën Kushtetuese, njëherësh shfrytëzojmë rastin ta ftojme gjithë spektrin politik që të gjejë zgjidhje që punëtorët në fund të këtij viti t'i marrin pagat ashtu si është pritur", është thënë në komunikatën e përbashkët të tri sindikatave.

Ndërkaq Lëvizja Vetëvendosje përmes një komunikate për media ka njoftuar për takimin që ka pasur Albin Kurti me përfaqësuesit e Sindikatës së Bashkuar të

Arsimit, të Shkencës dhe të Kulturës, të Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës dhe të Sindikatës së Policisë së Kosovës. "Fillimisht, përfaqësuesit e sindikatave shprehën falënderimet e tyre për gatishmërinë e përhershme të Lëvizjes Vetëvendosje për t'i takuar dhe trajtuar problemet e punëtorëve, për dallim nga kryeministri në ikje dhe presidenti aktual, nga të cilët nuk kanë marrë përgjigje në ftesat për takim. Ata e njoftuan Kurtin dhe të pranishmit e tjerë me qëndrimet e tyre mbi Ligjin mbi paga, i cili aktualisht po shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese. Ata shprehën shqetësimet e tyre me zhvillimet e fundit në raport me këtë ligj dhe njoftuan se janë në kontakt me Këshillat Drejtuese të secilës nga këto tri sindikata, me të cilat do t'i shqyrtojnë veprimet e ardhshme", është thënë në komunikatën e LV-së.

Sipas kësaj partie, të dyja palët u pajtuan se në raport me këtë çështje, çfarëdo hapi i mëtutjeshëm është i kushtëzuar nga dy procese të rëndësishme për vendin: formimi i institucioneve të Republikës së Kosovës dhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese për Ligjin mbi paga. "Gjithashtu, ato u pajtuan që, si asnjëherë më parë, për të gjitha çështjet të vazhdojë bashkëpunimi i afërt në mes të qeverisë së ardhshme dhe të gjitha sindikatave", është thënë në komunikatën e LV-së. Deputetët e legjislaturës së fundit



të Kuvendit të Kosovës me 62 vota për, asnjë kundër dhe 1 abstenim, në muajin shkurt të këtij viti, kishin miratuar Ligjin për paga në sektorin publik. Ligji

pritet ta rregullojë pagesën e të punësuarve që marrin paga nga buxheti i shtetit, ku koeficienti më i lartë është 10 dhe më i ulëti është 1 dhe vlera monetare e koeficien-

tit për vitin e parë do të jetë 239 euro. Sipas afateve të parapara në ligj, nga muaji dhjetor i këtij viti punëtorët e sektorit publik pritet t'i marrin pagat me rritje.

Punëtorët shëndetësorë të premtën hyjnë në grevë të përgjithshme

Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës gjatë takimit të Këshillit Drejtues të kësaj federate me shumicë votash ka marrë vendim që më 13 dhjetor të mbahet grevë e përgjithshme në tri nivelet e sis-

temit shëndetësor me moton "Presim pagat me ligjin e ri". Greva do të mbahet me fillim nga ora 7:00 deri në orën 15:00, me kërkesën për implementimin e Ligjit për paga që ka hyrë në fuqi më 1 dhjetor, por që

është dërguar në Kushtetuese nga Avokati i Popullit. Vendimin për grevë, po ashtu për ditën e premtë, pritet ta marrë nesër (e enjte) edhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës.

Rriten çmimet e mallrave të konsumit për 1,7 për qind

PRISHTINË, 11 DHJETOR (ER) - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar "Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit" (IHÇK) për muajin nëntor të vitit 2019, viti bazë 2015=100. Sipas ASK-së, inflacioni mujor i matur nga indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit ishte 0,2 për qind në muajin nëntor 2019. "Shkalla vjetore e inflacionit e matur në muajin nëntor 2019, krahasuar me muajin nëntor 2018 ishte 1,7 për qind. Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë për 0,2 për qind në muajin nëntor 2019 krahasuar me muajin tetor 2019. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit të nëngrupet e COICOP-it: qumështi, djathi dhe vezët (2,2 për qind), perimet (3,0 për qind), sigurimet (19,5 për qind)-(ngritja prej 26 për qind e çmimeve të sig-



urimeve të automjeteve çoi në një ngritje prej 0,1 përqindësh të IHÇK-it), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 0,3 përqindësh në IHÇK", është thënë në njoftimin e ASK-së, duke u shtuar se ngritja u neutralizua kryesisht nga rënia e çmimeve të nëngrupet e COICOP-it: pemët (-2,0 për

qind), shërbimet për transport (-2,1 për qind) - (rënia e çmimeve të biletave të transportit ajror me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej -0,1 përqindësh në IHÇK. "Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë për 1,7 për qind në muajin nëntor 2019 krahasuar me mua-

jin nëntor 2018. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë të nëngrupet e COICOP-it: buka dhe drithërat (7,0 për qind), mishi (2,0 për qind), qumështi, djathi dhe vezët (3,2 për qind), pemët (5,9 për qind), sheqeri, reçeli, mjalti, çokollata dhe ëmbëlsirat (2,0 për qind), prodhimet ushqimore, kripa, erëzat etj. (2,4 për qind), kafja, çaji dhe kakao (11,2 për qind), ujë, pijet joalkoolike, lëngjet nga pemët dhe perimet (1,4 për qind), pijet alkoolike (1,3 për qind), duhani (2,8), pajisjet shtëpiake (1,6 për qind), qelqirinat, takëmet dhe mjetet e kuzhinës (3,4 për qind), mallrat dhe shërbimet për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake (3,1 për qind), shërbimet ambulatorie (2,4 për qind), blerja e automjeteve (3, 6 për qind), shërbimet telefonike dhe

të telefaksit (0,9 për qind), shërbimet hoteliere (0,7 për qind), shërbimet e akomodimit (6,0 për qind), gjërat personale (3,3 për qind), sigurimet (19,5 për qind)-(ngritja prej 26 përqindësh e çmimeve të sigurimeve të automjeteve çoi në një ngritje prej 0,1 përqindësh të IHÇK-it), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 2,2 përqindësh në IHÇK", është bërë me dije në njoftimin e ASK-së. Sipas ASK-së, ngritja u neutralizua kryesisht nga rënia e çmimeve të konsumit të nëngrupet e COICOP-it: perimet (-5,0 për qind), përdorimi i pajisjeve për transportin personal (-2,3 për qind)-(rënia e çmimeve të naftës dhe benzinës), shërbimet për transport (-5,7 për qind)-(rënia e çmimeve të biletave të transportit ajror) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej -0,5 përqindësh në IHÇK.

Komuna e Kamenicës shpërndan mekanizma bujqësore për fermerët

KAMENICË, 11 DHJETOR (ER) - Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Komunën e Kamenicës ka shpërndarë mekanizma bujqësore për fermerët e kësaj komune. Mekanizmat bujqësore të cilat janë shpërndarë janë: 32 spërkatëse për kultura lavërtare dhe 25 shpërndarëse të plehut artificial.

Kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, ka uruar fermerët për përfitim të këtij mekanizmi bujqësor, duke potencuar se komuna do të jetë gjithmonë në mbështetje të tyre. Para shpërndarjes së mekanizmeve bujqësore, Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe

Zhvillimit Rural ka mbajtur edhe një temë trajnuese me fermerët për t'i informuar për mënyrën se si përdoren pesticidet me këto mjete.

Gjatë këtij takimi i pranishëm ishte edhe drejtori i kësaj drejtorie, Naim Arifi. Ai ka thënë se brenda dy vjetëve Komuna e Kamenicës është munduar sadopak t'u ndihmojë fermerëve, duke mbështetur mbi 255 fermerë në sektorë të ndryshëm nga kjo komunë e organizatat dhe 70 grante nga Ministria e Bujqësisë. Ky projekt është financuar 70 për qind nga Komuna e Kamenicës dhe 30 për qind nga fermerët. Vlera e gjithë projektit është 28 680 euro.



Anëtari i Shoqatës Down Syndrome fillon punën në 'Trafikun Urban'

Prishtinë, 11 dhjetor (ER) - Komuna e Prishtinës ka bërë me dije se hapja dhe ofrimi i mundësive, si dhe gjithëpërfshirja e kategorive të ndryshme në shoqëri, kontribuon në emancipimin e shoqërisë në përgjithësi. Në kuadër të gjithëpërfshirjes kjo komunë ka njoftuar se një anëtar i Shoqatës Down Syndrome është punësuar në ndërmarrjen "Trafiku Urban" në krye-

qytet. "Aldi, 23-vjeçar, është anëtar i Shoqatës Down Syndrome. Ai ka filluar punën në ndërmarrjen 'Trafiku Urban' ku e mban evidencën në hyrje-dalje të ndërmarrjes gjatë orarit të rregullt prej 08:00-16:00. Përgëzojmë ndërmarrjen 'Trafiku Urban' për mundësinë e ofruar dhe Aldi i urojmë suksese e punë të mbarë!", ka njoftuar Komuna e Prishtinës.



Mbahet fushatë vetëdijesuese për nxënësit me temë 'Stop dhunës në shkolla dhe shoqëri'

DEÇAN, 11 DHJETOR (ER) - Në kuadër të javës 16-ditore, organizata joqeveritare "Rinia", në bashkëpunim me Komunën e Deçanit, kanë filluar të mbajnë trajnime informuese, ndërgjegjësuere me nxënësit e Gjinnazit "Vëllezërit Frasheri" në Deçan, Shkollës Filllore "Lidhja e Prizrenit" si dhe nxënësit e Shkollës Filllore "Isa Boletini" në Isniq me temë "Stop dhunës në shkolla dhe shoqëri".

Komunë e Deçanit ka njoftuar

se nëpërmjet bashkëbisedimit është ngritur vetëdijesimi i nxënësve për të mos i heshtur rastet e dhunës, por t'i raportojnë ato duke shmangur rreziqet e përshkallëzimit të rasteve. "Gjatë trajnimit janë shpërndarë edhe broshura me karakter sensibilizues për nxënësit të cilat janë dizajnuar që ta adresojnë fushën e dhunës fizike dhe psikologjike. Gjetja më e rëndësishme ishte se dhuna nuk është një praktikë e pran-

uar në shtëpitë dhe shkollat, po ashtu është ngritur vetëdija e nxënësve kundër dhunës dhe ngacmimeve në shkolla si dhe janë shpërndarë qindra broshura me temë 'Stop dhunës në shkolla dhe shoqëri!', ka njoftuar kjo komunë. Sipas këtij njoftimi, drejtori i organizatës joqeveritare "Rinia", Liridon Istrefaj, në një ligjëratë me nxënës ka thënë se qëllimi i këtij trajnimit është shpërndarja e qasjes pozitive të rinjtë.



Komuna e Prizrenit javën e ardhshme mban debat me qytetarë për banimin social



PRIZREN, 11 DHJETOR (ER) - Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prizren, në bashkëpunim me organizatën "Developing Together", më 18 dhjetor do të organizojë debat me qytetarë për prezantimin e objektivave

konkrete të cilat janë të parapara në programin trevjeçar për banim social. Kjo komunë ka theksuar se banimi është një nga të drejtat themelore njerëzore, i njohur nga shumë konventa dhe ligje ndërkombëtare. "Dhe sipas legjis-

lacionit në fuqi, komunat e Kosovës obligohen t'i ndihmojnë me banim familjet të cilat nuk mund ta sigurojnë vetë banimin. Komuna e Prizrenit e ka aprovuar Programin trevjeçar për banim, i cili është përkrahur nga

'Developing Together' në fushën e banimit social. Debatimi me qytetarë do të mbahet të mërkurën më 18 dhjetor 2019, në sallën e Kuvendit Komunal (Shtëpia e Bardhë), duke filluar nga ora 10:00", ka njoftuar Komuna e Prizrenit.

Drejtorja e Inspeksionit në Mitrovicë liron hapësirat publike

MITROVICË, 11 DHJETOR (ER) - Në vazhdim të inspeksioneve të përditshme për lirimin e hapësirave publike të uzurpuara, me kërkesë të qytetarëve të Mitrovicës, inspektorët komunalë kanë ndër-

marrë aksion në rrugët "Agim Ramadani - Katana", "Evlija Qelebia", "11 Marsi" dhe "Mbretëresha Teutë" duke bërë lirimin e tyre. Me këtë rast, inspektorët komunalë kanë konstatuar se në ato

hapësira janë vendosur shufra metalike me zinxhirë pa poseduar leje nga organi kompetent, duke dëmtuar kështu trotuarët të cilat shërbejnë për qarkullim të lirë të qytetarëve. Drejtori i

Inspeksionit, Hysni Ahmeti, ka bërë me dije se aksione të kësaj lloji do të vazhdojnë deri në eliminimin e tërësishëm të kësaj dukurie në mënyrë që të lirohen hapësirat e uzurpuara komunale.



Erdogani admiron Trumpin dhe Putinin

ANKARA, 11 DHJETOR - Presidenti turk, Rexhep Tajip Erdogan, ka renditur presidentin amerikan Donald Trump dhe atë rus, Vladimir Putin, në mesin e liderëve që admiron më së shumti, teksa ka thënë se Evropës i mungon një lider frymëzues. Duke folur para studentëve në kryeqytetin turk, Ankara, Erdogan ka thënë se Evropa po përballet me "kriizë serioze të udhëheqjes".

Ai ka përshëndetur Trumpin, për siç ka thënë, natyrën e tij të hapur. "Pavarësisht se a e pëlqeni apo jo, Trumpi është një emër i rëndësishëm. Ai nuk ka agjendë të fshehur. Ai diskuton me mua hapur dhe unë flas me të shumë hapur", ka thënë presidenti turk. Ngjashëm Erdogan ka përshkruar edhe Putinin, duke thënë se as ai nuk ka "agjendë të fshehur".

Lideri i tretë i përmendur nga udhëheqësi turk, ka qenë sheiku i Katarit, Tamim bin Hamad Al Thani, për të cilin Erdogan ka thënë se është "lider i ri dhe dinamik", i cili mbështet shtetet e varfra. Nga e kaluara, Erdogan ka përmendur Profetin Muhamed dhe themeluesin e Turqisë moderne, Mustafa Kemal Atatürk në mesin e personaliteteve frymëzuese për të.



Trumpi paralajmëron Rusinë kundër ndërhyrjes në zgjedhje

Marrëdhëniet ShBA-Rusi janë në nivelin më të ulët prej periudhës së Luftës së Ftohtë, pas aneksimit të Krimesë nga Ukraina më 2014, ndërhyrjes së saj në zgjedhjet amerikane, fushatat e dezinformimit dhe sponsorizimit të vrasjeve në botë



WASHINGTON, 11 DHJETOR - Presidenti amerikan Donald Trump ka paralajmëruar ministrin e Jashtëm rus, Sergei Lavrov, kundër çfarëdo "përpjekjeje për të ndërhyrë" në zgjedhjet e Shteteve të Bashkuara dhe "i ka bërë thirrje Moskës për ta zgjidhur konfliktin me Ukrainën", është thënë në deklaratën e Shtëpisë së Bardhë, pas takimit mes dy zyrtarëve në Uashington, ka njoftuar rfe. Trumpi ka theksuar se mbështet "kontrollin efektiv të armëve në botë", duke përfshirë jo vetëm Rusinë, por edhe Kinën. Trump i ka kërkuar Rusisë mbështetje në të ndalurit e Iranit nga zhvillimi i armëve bërthamore, si dhe në sigurimin e denuklearizimit të Koresë Veriore. Vizita e Lavrovit vjen një ditë pas bisedimeve katërpalëshe në Paris në mes të Rusisë, Francës, Gjermanisë dhe Ukrainës, për t'i dhënë fund konfliktit në lindje të Ukrainës. Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo është takuar po ashtu me Lavrovin, të cilët kanë treguar pak shenja të përparimit në marrëdhëniet ShBA-Rusi. Megjithatë, Pompeo ka shprehur bindjen se kjo situatë do të ndryshojë. Të dy kanë diskutuar një varg

çështjesh ndërkombëtare, duke përfshirë denuklearizimin e Koresë Veriore, ndryshimin e udhëheqjes në Venezuelë si dhe ndërhyrjen e Rusisë në zgjedhjet presidenciale të vitit 2016 në ShBA. Marrëdhëniet ShBA-Rusi janë në nivelin më të ulët prej periudhës së Luftës së Ftohtë, pas aneksimit të Krimesë nga Ukraina më 2014, ndërhyrjes së saj në zgjedhjet amerikane, fushatat e dezinformimit dhe sponsorizimit të vrasjeve në botë. Rusia mohon ndërhyrjen në çështje të brendshme dhe përfshirjen në vrasje pavarësisht të dhënave që e thonë të kundërtën. Lavrovi ka deklaruar sërish se Rusia nuk ka ndërhyrë në zgjedhjet e SHBA-së dhe ka thënë se shteti i tij është gati të publikojë "kanalin sekret" të komunikimeve në mes të Moskës dhe Uashingtonit nga tetori i vitit 2016 deri në nëntor të vitit 2017, pasi sipas tij, ai do të mbështeste pretendimet e tij. Pompeo e ka kundërshtuar këtë ide, duke thënë se ka mjaft të dhëna që mbështesin përfundimin e Uashingtonit për ndërhyrje. "Ne do t'i publikojmë të gjitha dokumentet që mendojmë se janë adekuate. Ne mendojmë se kemi shpërndarë mjaft

të dhëna për të treguar çfarë ka ndodhur në zgjedhjet e vitit 2016 me homologët tanë rusë", është shprehur Pompeo. Megjithatë, ai ka thënë se shpreson që të dyja kombet do t'i tejkalojnë problemet. "Ne duhet të kemi marrëdhënie më të mira, ShBA-ja dhe Rusia, në krahasim me ato që kemi pasur vitet e fundit", ka thënë Pompeo në një konferencë për media pas takimit me Lavrovin. Sekretari amerikan i Shtetit ka thënë se ShBA-ja dhe Rusia do të vazhdojnë bashkëpunimin në luftimin e terrorizimit dhe trafikimit të drogës, pavarësisht tensionimit të marrëdhënieve. Ata kanë thënë se marrëdhëniet tregtare mes të të dyja shteteve janë rritur lehtë, mirëpo sërish palët kanë shprehur më shumë

mosmarrëveshje, sesa unitet. Pompeo i ka kërkuar Rusisë që t'i japë fund mbështetjes për liderin e Venezuelës, Nicolas Maduro, dhe të lejojë mbajtjen e zgjedhjeve në shtetin e Amerikës Jugore. Rusia ka përkrahur vazhdimisht qeverinë e Maduros, në kohën e rritjes së protestave në këtë vend, duke përmendur kushtet e rënda ekonomike. Pompeo po ashtu ka ritheksuar qëndrimin amerikan që Krimea i përket Ukrainës dhe se Rusia duhet t'i përmbushë obligimet për të arritur paqe në lindje të Ukrainës, ku nga luftimet mes forcave qeveritare të Kievit dhe separatistëve të mbështetur nga Rusia kanë vdekur më shumë se 13,000 persona nga prilli i vitit 2014. Pompeo ka shpenzuar "një pjesë

të madhe të kohës" duke diskutuar për Ukrainën me Lavrovin, i cili ka marrë pjesë në bisedimet për paqe në mes të Putinit dhe Zelenskiyt në Paris dy ditë më parë. Lavrovi ka krahasuar atmosferën aktuale në Uashington kundrejt Rusisë me atë të viteve 1950, një periudhë e histerisë për ndikimin komunist të Qeverisë amerikane. Ministri i Jashtëm rus është ankuar se ka qenë e vështirë që të arrihet përparim në kushte të tilla. Sipas tij, Kremli është i gatshëm të vazhdojë marrëveshjen "Fillimi ri", e cila përbën marrëveshjen e fundit bërthamore në mes të të dyja shteteve. Pompeo ka thënë se dëshiron të vazhdojë marrëveshjen e cila skadon në shkurt të vitit 2021, duke përfshirë në të edhe Kinën.

Sulmuesit në New Jersey kishin në shënjestër një dyqan të hebrenjve

Nju Jersey, 11 dhjetor - Policia në New Jersey tha se një dyqan i hebrenjve ka qenë në shënjestër të sulmit të armatosur që la gjashtë persona të vrarë, përfshirë dy sulmuesit. Ende nuk janë bërë të ditura zyrtarisht motivet e incidentit që ndodhi më 10 dhjetor, por kryetari i qytetit, Steven Fulop,

tha se "urrejtja dhe antisemitizmi" nuk kanë vend në këtë qytet. Përleshja filloi kur të dyshuarit vranë një polic, pastaj përmes një furgoni të marrë me qira shkuan në dyqan. Videot e sigurisë treguan se ata sulmuan me armë dyqanin para se të futen brenda. Sulmuesit u vranë brenda

ndërtesës pas një bllokimi prej rreth katër orësh nga ana e policisë. Identiteti i sulmuesve ende nuk është bërë publik. "New York Times" raportoi të mërkurën se njëri prej të dyshuarve kishte bërë postime antisemite dhe antipolicore në internet, por kjo ende nuk është konfirmuar.



Eshaloni i UÇK-së në luftë me forcat armike të pritës dhe dimrin e acartë në Pashtrik (4)

TËRHEQJA NË DREJTIM TË SHQIPËRISË



LULZIM SAHITI

Menjëherë pas Drinit, në fshatin Kushnin kanë arritur të hyjnë edhe Florim Qelaj nga Peja, që ishte kapiten në ish-armatën jugosllave, Shkelzen Pepshi nga Peja, Nysret Krasniqi "Hansi" nga Peja, po ashtu ishte rreshter në ish-ushtarinë jugosllave, Hysni Kuçi nga Suhareka, Ylli Elshani nga Suhareka dhe një ushtar tjetër emrin e të cilit nuk kemi arritur ta identifikojmë. Luftëtarët e UÇK-së qëndrojnë në Kushnin deri rreth orës 22:00. Atë natë Nexhmedin Berisha ka vënë kontakt me Njësitin e UÇK-së në Rogovë të Hasit, me ç'rast udhëheqësi i skuadrës së UÇK-së, Kapllan Hoti, së bashku me Ibrahim Shalën, Xhavit Berishën, Osman Berishën e të tjerë, vijnë nga Rogova për ta ndihmuar tërheqjen e tre ushtarëve të plagosur dhe të bashkëluftëtarëve të tjerë. Të plagosurit janë bartur me një qerre me kalë. Gjatë


udhëtimit kanë hasur edhe në ushtarë të tjerë të cilët kishin humbur rrugën dhe iu bashkuan grupit të tyre. Ky udhëtim ka qenë i gjatë dhe i mundimshëm për arsye se në një pjesë të rrugës, komandant Mahiri është dashur të bartet edhe në shpinë. I gjithë udhëtimi është kryer jo në rrugë ekzistuese, por nëpër ara, therë e shkurre, vetëm që t'i shmangen ballafaqimit me forcat serbe. Rreth orës 4:00 të mëngjesit mbërrin në Rogovë. Ata vendosen në dy shtëpi, njëri grup i ushtarëve me komandant Drinin vendosen te shtëpia e Asllan Berishës, ndërsa grupi tjetër me Mahir Hasanin vendosen në kullën dykatëshe të Halil Osmanit-Berishës. Kur hyjnë brenda në odën madhështore, shohin përplot burra. Kjo odë ishte rregulluar bukur, por atë e zbukuronin edhe më shumë ata njerëz që ishin brenda me pritjen e tyre burrërore. Kryefamiljari mikpritës, luftëtarin e lirisë Mahir Hasani e vendos në ballë të oxhakut, të cilin atë natë nuk kishte mbetur njeri pa e përshëndetur. Madje disave iu mbushën sytë me lot. Mahiri ndiente dhembje nga plaga që kishte marrë në këmbë. Afër tij ishte ulur një burrë i vjetër, me shtat të lartë, që barte në kokë një plis të bardhë. E gjithë oda ishte shtruar me postiqe të bardha si bora, ndërkohë të plagosurit filloi t'i rridhte gjak nga

këmba. Nga i zoti i shtëpisë (Halili), që kishte pranë vetes, Mahiri kërkoi një peshqir për të mos lënë gjakun të pikë në postiqe. Çka ndodhi? I zoti i konakut ngritet në dy gjunjë dhe me zë të lartë thotë: "O komandant, shyqyr që na solli Zoti të derdhim gjak për vendin tonë dhe çdo pikë gjaku do të jetë udhërrëfyes për gjeneratat që vijnë. Ky gjak i juaji dhe i shumë luftëtarëve të tjerë do të jetë dëshmi e vullë e lirisë së popullit të Kosovës dhe mbarë shqiptarisë. Andaj, i nderuar, qofsh faqebardhë ti dhe familja juaj që kanë lënë dikë mbrapa me i dal zot kësaj toke! Qofsh me jetë të gjatë! Shtrije këmbën e le të rrjedhë ai gjak edhe në këto postiqe të kësaj kulle, që edhe këto ta marrin ngjyrën e lirisë!", përfundon babagyshi i Nexhmedin Berishës. Në mesditën e 15 dhjetorit, duke vërejtur se situata ishte shumë e tensionuar nga ana e forcave serbe, Nexhmedin Berisha ka përgatitur planin për transferimin e të plagosurve dhe ushtarëve të tjerë nga Rogova për në fshatin Krushë e Madhe, ku kishte staf mjekësor. Me njësitin e vet, Nexhmedini kishte organizuar rreth 30 ushtarë për përcjelljen e tyre, ndërkaq nga Njësitin e Rogovës kishte organizuar rreth 20 veta të tjerë të Brigadës 124, të cilët e kishin për detyrë ta vëzhgonin terrenin dhe ta siguronin rrugën Rogovë - Krushë e Madhe

që e kontrollonin forcat serbe. Pra, udhëtimi është zhvilluar rrugës kryesore nga lëviznin edhe forcat armike. Me të arritur në Krushë të Madhe, të plagosurit i dërgojnë në një shtëpi - ambulancë, ku shërbente dr. Fahredin Sh. Hoti. Pas 27 orëve, ai ua ofron ndihmën e parë, mandej transferohen në spitalin e porsathemeluar në Pagarushë të Malishevës, në të cilin shërbente dr. Agim Hazrolli me stafin mjekësor. Menjëherë pas sulmit ndaj ekipit të pararojës së UÇK-së që ndodhi rreth 500 metra para, u bë shpëtim në mes të vëzhguesve dhe kolonës, e cila u ndal në vend dhe pret vendimin e mëtutjeshëm të eprorëve të tyre ushtarakë. Mbi një orë është diskutuar dhe analizuar vazhdimi i rrugës për në Kosovë apo kthimi për në Shqipëri. Gjatë kësaj kohe, në vendin nga erdhën krismat armike, Komandant "Kapuçi" është nisur teposhtë luginës për t'i parë pozicionet e forcave armike dhe mundësinë e depërtimit të kolonës tutje. Në këto çaste ushtarët ishin ulur për t'u çlodhur pak dhe disa shfrytëzonin kohën për ta bërë ndërrimin e çorapëve të lagura nga bora. Rreth orës 6:00 ai është kthyer dhe para gjithë ushtarëve që vinin nga Zona Operative e Drenicës, Pashtrikut dhe Nerodimes, komandant Mujë Krasniqi ka deklaruar publikisht

se "pas vëzhgimit të terrenit që kam bërë në këtë pjesë ku kemi planifikuar të kalojmë, nuk ka asnjë mundësi të ecim tutje, prandaj duhet të rikthehemi për në Shqipëri". Ai kërkon që t'i lënë në atë vend të gjitha pajisjet e rënda ushtarake, përpos armatimit dhe municionit personal për vetëmbrojtje. Në këto çaste të rënda, Mujë Krasniqi ndiente përgjegjësi të lartë si komandant i këtij eshaloni të UÇK-së dhe llogariste hyrjen në fshatin Lubizhdë me pasoja të mëdha, meqë tashmë kjo zonë kufitare ishte rrethuar nga forca të mëdha ushtarake serbe ku, krahas ushtarëve të UÇK-së, do të pësojë edhe popullata civile e kësaj zone.

Askush nuk e imagjinonte se gjatë kthimit në drejtim të Shqipërisë do të ballafaqohen me forcat e armikut. Ushtarët që kishin bërë mbi 18 orë udhëtim tashmë ishin të lodhur, të uritur, pa ujë, pa gjumë, të ftohur nga acari i madh. Kishte të atillë që më me mall e bënë vdekjen sesa kthimin. Bile Rrahman Tafa nga lodhja e madhe që kishte, kërkonte me ngulmë ta vazhdojnë rrugën tutje për Kosovë. Mirëpo, përgjegjësi i ushtarëve të ZON-së dhe Batalionit "Ruzhdi Salihu", Afrim Musliu, arrin t'i bindë ushtarët me urdhrin e komandant "Kapuçit" dhe vazhdojnë marshimin drejt Shqipërisë. (Vijon)



Luftëtarët e lirisë, nga e majta në të djathtë: Bislim Muçaj dhe Mahir Hasani gjatë shërimit të plagëve të luftës në Pagarushë



AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333

E jashtëzakonshme

Pema e Krishtlindjeve më modeste në botë

Atmosfera e festave të fundvitit ka nisur të ndihet në McComb, Mississippi. Qytetarë të shumta kanë rregulluar pemën e Krishtlindjeve në shtëpitë e veta. Por, ndryshe nga vitet e kaluara, banorë të asaj zone kanë zbuluar edhe rrugët e qytetit, pasi Bashkia e la në mëshirë të fatit. Të gjenur në këtë situatë, qytetarët morën guximin për ta zbuluar vetë qytetin dhe këtë e bëjnë në kushte vërtet primitive. Pema e Krishtlindjeve nuk është ajo tradicionale. Bredhi me degët e saj të mbushur me zbulime dhe me pambuk, që personifikon dëborën është zëvendësuar me një



tabelë trafiku dhe topa zbulimi vendosur nga qytetarë të shumtë.

FOTO E DITES




Një punëtor në Bangkok shihet nga një lartësi e madhe duke instaluar dritat e Krishtlindjes dhe Vitit të Ri. /AFP/

E rrallë

Shtëpi të lira për popullin e thjeshtë meksikan

Në fillim të viteve 2000 qeveria meksikane nisi një projekt ambicioz që të ndërtonte shtëpi të përballueshme nga miliona banorë me mundësi të pakta financiare. Më shumë se 100 miliardë u përdorën për të ndërtuar me qindra blloqe banimi me shtëpi të vogla, të rehatshme e të përballueshme në çmim, por jo çdo gjë shkoi sipas planit. Ndonëse me miliona njerëz kanë gjetur



strehim të përballueshëm, korrupsioni, planifikimet e gabuara dhe metodat e nxituara të ndërtimit bënë që edhe sot, shumë prej këtyre shtëpive të mos kenë rrjet uji të pijshëm dhe as ujëra të zeza. Shumë blloqe të tjera kanë qenë një sukses, por arkitektët dhe fotografët e kanë kritikuar mënyrën e ndërtimit të qindra shtëpive identike, të ngjeshura me njëra-tjetrën në blloqe të veçanta.

BARSOLETA E DITËS



Shitësi i drejtohet të birit:
- Pse more bir i ke pirë gjithë këto "Cola Cola"?
- Kanoçet po shiten shtrenjtë babi. A i ke parë njerëzit qysh po i mbledhin nëpër kontejnerë?!




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetëm gjatë vikendit në ora 13:00

The Addams Family / 3D

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 orë 27 min
Rolet: Oscar Isaac, Charlize Theron, Chloë Grace Moretz, Finn Wolfhard, Nick Kroll, Bette Midler, Allison Janney, etj.
Regjia: Conrad Vernon And Greg Tiernan



Çdo ditë në ora 15:00 dhe 17:00

FROZEN 2 / 3D

I Animuar/Aventure/Komedi; 1 orë 43 min

Rolet: Kristen Bell, Idina Menzel, Josh Gad, Jonathan Groff, Jason Ritter, etj.

Regjia: Chris Buck, Jennifer Lee



Çdo natë në ora 19:00

FORD V FERRARI

Aksion/Biografi/Dramë; 2 orë 32 min

Rolet: Matt Damon, Christian Bale, Jon Bernthal, Caitriona Balfé, Tracy Letts, Josh Lucas, Noah Jupe, Remo Girone, Ray McKinnon, etj.

Regjia: James Mangold



Çdo natë në ora 21:30

TERMINATOR DARK FATE

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 2 orë 14 min

Rolet: Linda Hamilton, Arnold Schwarzenegger, Mackenzie Davis, Gabriel Luna, Natalia Reyes, Diego Boneta, Edward Furlong, etj.

Regjia: Tim Miller



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).

| | | | | | |
|---|--|---|---|--|--|
|  <p>DASHI Sot do të pendoheni për disa shpenzime të bëra kohët e fundit sepse po shikoni që nuk i keni pasur fare të nevojshme.</p> |  <p>DEMI Të gjithë ju që keni mjaft kohë në dispozicion duhet të filloni të merreni me aktivitete fizike.</p> |  <p>BINJAKËT Keni përkrahjen e miqve tuaj në çdo hap që doni të bëni. Ndryshime të mëdha parashikohen për ju dhe jeni stepur disi nga e panjohura.</p> |  <p>GAFORRJA Sot jeni tipa ëndërrimtarë dhe mendja ju rri vetëm te çastet e bukura. Shumë shpejt do të duhet të ktheheni me këmbë në tokë se dita është mjaft e ngjeshur.</p> |  <p>LUANI Jeni tipa të pavarur dhe do ta shprehni mendimin tuaj edhe me kosto të lartë nga mbrapa. Kufizimet dhe kornizat nuk janë në stilin tuaj.</p> |  <p>VIRGJËRËSHA Edhe pse së fundmi nuk keni mjaft ndërveprim me partnerin, kjo gjë nuk ju pengon të bëni plane bashkë. Ndiheni të dy të lodhur nga rutina.</p> |
|  <p>PESHORJA Nëse doni të debatonit me dikë është mirë që ta bëni për situata të së tashmes dhe jo duke sjellë në valle të shkuarën e gjithsecilit.</p> |  <p>AKREPI Sot ju ka pushtuar një xhelozsi e pashpjegueshme që do të ketë pasojë jo të mira në lidhjen tuaj. Do të merrni të mirëqenë çdo gjë që do t'ju thuhet.</p> |  <p>SHIGJETARI Mjaft entuziast sot në çdo gjë që do t'ju komunikohet. Ndiheni si fëmijë që po i dhurojnë një lodër që mezi e prisnit dhe doni ta eksploron.</p> |  <p>BRICJAPI Kujdes me hapat e gabuar sepse mund t'ju çojnë në një rrugë pa krye. Ndonjëherë bëni mirë të kërkoni ndihmë kur jeni në kohë.</p> |  <p>UJORI Nuk lejoni askënd t'i prekë parimet tuaja dhe për këtë gjë jeni mjaft krenarë, por të tjerët do ta keqinterpretojnë këtë virtut që keni.</p> |  <p>PESHQIT Kjo ditë do të nisë me ide të reja që doni t'i vini sa më shpejt në zbatim. Do të kuptoni që nëse gjërat nisin mbarë, finalizimi do të jetë shumë i shpejtë.</p> |

Ed Sheeran shpallet "Artisti i Dekadës" në Mbretërinë e Bashkuar



Ed Sheeran është emëruar "Artisti i Dekadës" në Mbretërinë e Bashkuar. Sheeran arriti sukses në listën e Company Official Charts pas një ekzekutimi të kombinuar të 12

këngëve dhe albumeve midis 2010-s dhe 2019-s më shumë se çdo artist tjetër. "Shape Of You" ishte hiti më i madh i viteve 2010, duke kaluar 14 javë në numrin një dhe duke shitur më shumë se 4.5 milionë kopje.



Bebe Rexha, 10 milionë ndjekës në 'Instagram'

Këngëtarja me origjinë shqiptare Bebe Rexha tashmë ka prekur majat e famës dhe ndjekësit e saj në rrjetet sociale shtohen çdo ditë. Së fundmi këngëtarja ka arritur 10 milionë ndjekës në 'Instagram' dhe këtë gjë e ka festuar me një video shumë të veçantë. Bebe ka bërë bashkë në një klip çaste të ndryshme nga

jeta e vet qëkur ishte e vogël e deri në ditët e sotme. "10 milionë prej jush... e pabesueshme. Nuk dua të jem e fiksuar pas numrave, por është një bekim të kesh një audiencë. Nuk ka qenë gjithmonë kështu. Faleminderit Rexharst e mi të bukur! Ju dua shumë. Ne e bëmë këtë gjë bashkë", ka shkruar Bebe në një postim në 'Instagram'.

Jennifer Lopez zhvishet nga diamantët dhe aksesorët, ndan fotografinë pa grim



Jennifer Lopez e di se si të vishet për një rast: qoftë në një qilim të kuq ose në një fustan martese, të lë pa frymë. Por J. Lo ndau një çast të rrallë të zhveshur nga diamantet dhe aksesorët

që rregullisht bën një i famshëm. Aktorja dhe këngëtarja 50-vjeçare ka postuar një selfie bërë vetes pa grim. Jennifer Lopez ishte e shoqëruar edhe nga binjakët Emme dhe Max.

Kate Hudson ka filluar të krijojë linjë të vodkës



Aktorja e njohur Kate Hudson ka vendosur të dalë pak jashtë fushës së saj. Hudsoni ka vendosur që të prodhojë pije alkooolike të llojit vodka. Ajo në një intervistë ka thënë se ndihet mirë që ka filluar të merret me biznes.

"Kjo është shumë interesante. Kjo vodka deri 56 për qind është blerë nga gratë", ka thënë ajo. Hudsoni ka thënë se dëshiron të jetë distributore femër në këtë fushë në të cilën shumë pak gra janë afariste të pijeve alkooolike.

Homazh me rastin e 50-vjetorit të vdekjes së atdhetarit Mulla Nuredin Maxherës

Mulla Nuredin Maxhera, një

(Pas komunikimit të atkgjykimit, gjykatësi e pyet hoxhën a është i kënaqur me lartësinë e dënimit. Hoxha i përgjigjet se i vjen keq që nuk ka mundur të punojë edhe më tepër për popullin e vet)



Prof. dr. Sabile Keçmezi-Basha

Duke hulumtuar për organizimin, veprimtarinë dhe arretimin e anëtarëve të organizatës ilegale "Organizata Revolucionare për Bashkimin e Kosovës me Shqipërinë" të Kadri Halimit, më bëri përshtypje se në shumë vende përmendej hoxha atdhetar - Mulla Nuredin Maxhera. Hoxhë Maxhera ishte një ndër figurat e ndritshme që më zgjoi kërkimin dhe më nxiti të hulumtoja dhe të dija diç më tepër për jetën dhe veprën e këtij atdhetari të madhe. Ai, pa dyshim, ishte figurë emblematike dhe një ndër organizatorët e lëvizjes ilegale shqiptare në anën e Preshevës. Mulla Nuredin Maxhera ishte personalitet që e stolisnin virtyte të larta si: urtësia, trimëria, dashuria e pakufizuar ndaj atdheut, njeri i besës, fjalëpakë, i mençur dhe organizator e veprimtar për mbrojtjen e tokave shqiptare.

Kush ishte Mulla Nuredin Maxhera

Nuredin Xhemajli, si do të njihet më vonë Mulla Nuredin Maxhera (mbiemër që do ta marrë në bazë të fshatit ku kishte lindur, që quhej Maxhera, në Malësinë e Karadakut të Preshevës). Nuredin Xhemajli lindi në fshatin Maxherë në vitin 1902. Në kohën kur lindi ai Lëvizja Kombëtare Shqiptare bënte përgatitjet e mëdha për aktin më të madhërishtë: shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë.

Familja e Nuredinit ishte një familje atdhetare dhe asnjëherë nuk kursente për çështje të kombit dhe për çështjen kombëtare. Me kalimin e viteve i riu Nuredin fitonte tiparet e të parëve për atdhetari dhe për

zguarsi. Shkollën fillore e mbaroi në Preshevë, ndërsa Medresenë e vazhdoi dhe e përfundoi me sukses të dalluar në Gjilan. Pas përfundimit të medresesë, pasi mungesa e njerëzve të shkolluar ishte e dukshme, ai vendos të angazhohet në fshatin e vet si imam, ndërkohë shërbente edhe në fshatrat për rreth si: në Sllubicë, Gare, Maxhere, Bukoc, Gosponicë etj.

Gjithsesi, duhet përmendur se, angazhimi i tij si hoxhë ishte i mirëseardhur për veprimtarinë ilegale që ai ishte angazhuar katërçipërisht. Shpesh ndodhte që ligjëratat e tij të mbajtura para xhematit shndërroheshin në një kushtim të lirisë për popullin shqiptar të asaj ane. Mulla Nuredini, përveç përgatitjes shkollore që kishte, kishte të lindur oratorinë dhe aftësinë që të ishte i afërt me njerëzit dhe fliste shtruar me ta, për problemet e përditshme, por edhe ato kombëtare që e mundonin popullin. Ishte një njeri i devotshëm, por edhe atdhetar i madh. Robërinë dhe okupatorët nuk i duronte dot. Shpesh ndodhte që në xhamitë ku mbante ligjërimi ai tërësisht ia kushtonte luftës dhe çështjes së pazgjidhur shqiptare.

Më 1941 deri më 1944 Kosova mbeti e ndarë në tri zona pushtimi atë italiane, gjermane e bullgare. Pasi Maxhera e Presheva ngelën nën zonën bullgare, familja e hoxhë Maxherës u detyrua të shpërngulën për në Përlepnice, Komuna e Gjilanit. Atje familja qëndroi për tre vjet duke e ndier veten më të sigurt ngaqë veprimtaria dhe aktiviteti i hoxhës që në ditët e para iu kishte rënë në sy armiqve të popullit shqiptarë.

Gjatë qëndrimit në fshatin e Përlepnice, hoxha atdhetar me takimet që mbante me fshatarët, hetoi me të madhe padrejtësinë që po i bëhej popullit shqiptar dhe mu kjo ndikoi që të mos rrinte duarkryq. Gjatë kësaj kohe pati takime të shumta me atdhetarët e asaj ane, por edhe krijoi miqësi të reja me familjet më në zë të kohës. Kishte miqësi me atdhetarin e njohur të Anamoravës, Ramiz Cërnicën, Zeqë Vërbanin e



Mulla Nuredin - Maxhera

shumë të tjerë. Duke e konstatuar se gjakmarrja ishte plagë e pambyllur e popullit tonë, ai zhvilloi shumë aktivitete që ta mbyllte këtë plagë. Populli duke e parë dashurinë e madhe të hoxhës ndaj kombit, propozoi dhe zgjodhi si kryeplak të Këshillit të Pajtimit të Gjaqeve në Malësinë e Karadakut. Janë të njohura në popull sa e sa pajtime të gjaqeve që u bënë me ndërmjetësimin e vet mulla Nuredinit.

Situata politike në Kosovë më 1945

Qëndresa e popullit shqiptar nuk është e njohur vetëm në dekadat e fundit të shekullit XX. Ajo ka filluar shumë më herët se Konferenca e Bujanit (31 dhjetor 1943 - 1 e 2 janar 1944), se Kuvendi i Prizrenit (1945), se Kryengritja e Drenicës (1945), e se shumë e shumë ngjarje madhore të historisë sonë. Mirëpo, ndër sfidat më të mëdha ishte viti 1945 dhe periudha që pason. Ishte koha kur shqiptarët, pa dëshirën e tyre, mbetën në kuadër të Serbisë e të ish-Jugosllavisë. Nuk ishte hera e parë që shqiptarëve iu mohua një e drejtë e ligjshme e tyre, por ky do të jetë mashtrimi më i madh që komunistët jugosllavë

ua bënë shqiptarëve. Andaj, rezistenca ishte fati ynë historik. Deri vonë historiografia

shqiptare nuk u mor me këto ngjarje jo vetëm pse okupuesi u kujdes që t'i shpallte tema tabu, siç e patën shpallur të tillë tërë rezistencën shqiptare kundër robërisë, por edhe pse ende nuk ishte mbyllur fleta e fundit e kësaj historie, e cila vazhdoi të rridhte gjithnjë e më bujshëm në viset etnike shqiptare.

Pas vitit 1945 Kosova përsëri u robërua. Shqiptarët përsëri vendosën të qëndronin dhe të rezistonin ashtu siç i kishin mësuar shekujt dhe të parët. Edhe më tutje në rend të obligimeve historike mbeti obligimi dhe qëllimi suprem i lëvizjes - çlirimi i trojeve të mbetura nën sundimin e huaj dhe bashkimi i tyre me shtetin amë. Kjo dëshmon se lufta e armatosur që nisën djemtë e vashat më të mira të Kosovës më 1998 i ka rrënjët qysh te pushtimi osman, kur populli shqiptar u ngrit si një për ta çliruar vendin e për t'u vënë krahë popujve të Evropës dhe të Ballkanit me shtetin e vet kombëtar.

Vendosja e administrimit ushtarak (8 shkurt 1945) dhe më vonë, në vitet që pasuan, bëri që monarkia jugosllave të vishej me këmbës të re. Shovinistët serbomalazias, me yllin partizan në ballë, e kthyen Kosovën në një kasaphanë të paparë. Popullata shqiptare, bijtë dhe bijat më të mira të kombit, binin nga rafalët. Fshatra të tëra bëheshin hi e pluhur nga flaka e lubisë serbe. OZN-a famëkeqe, e



jetë e tërë për atdhe e fe

më vonë UDB-a, fillojnë ekspeditat e tyre kriminale. Mijëra të tjerë u masakruan në Mitrovicë, në Gjilan, në Ferizaj, në Podujevë, në Istog, në Pejë, në Prizren e në vende të tjera gjithandej ku jetonin shqiptarët. Në emër të pastrimeve nga elementet armiqësore, dhjetëra e mijëra shqiptarë u zhdukën pa gjurmë. Në këto kushte të llahtarshme Kosova gjeti forcë dhe nisi rezistencën e gjatë. Dhe, që në fillim u ngrit Drenica. Prijësi popullor Shaban Polluzha, në vend se të shkonte në Srem, ku e urdhëronin komandantët, me tetë mijë luftëtarë kthehet në Drenicën trime për t'i mbrojtur gratë e fëmijët shqiptarë nga dëliri gjakpirës i divizioneve serbomalaziasë, të udhëhequra nga koloneli Sava Derleviq. Kryengritja e Drenicës u shua me gjak. E përgjakur deri në asht, e lidhur këmbë e krye nga dhuna e pushtetit ushtarak, Kosova arriti në Kuvendin e Prizrenit, që u mbajt më 8-10 korrik 1945.

Pas këtij kuvendi, pasoi një periudhë e rëndë e sëmurë. Kjo kohë shumë pak premtonte se diçka e re dhe e mirë do të lindte në horizontin e zi të Kosovës. Qeveria e re, pinjolle e pushtetit të vjetër, vazhdonte me përpjekje të ethshme që në çdo pore të jetës të shuante çdo ndjenjë kombëtare dhe liridashëse. Edhe pse presionet vazhdonin, populli gjeti një mënyrë tjetër të

rezistencës, që ishte shumë më kuptimplotë, ama edhe ishte e rrezikshme. Në ilegalitet të thellë filluan të vepronin organizatat e shumta patriotike shqiptare, si: Komiteti Nacional Demokratik Shqiptar, Besa Kombëtare dhe disa të tjera më të vogla. Lëvizja patriotike shqiptare në Kosovë kishte një shtrirje të madhe në kohë dhe në hapësirë, që përfshinte vitet 1945-1998, me aktivitete dhe me problematikë të larmishme, me çaste kulmore dhe herë-herë shpërthyes, që dilte nga suazat e ilegalitetit, si në vitet 1968, 1971, 1981, 1989 dhe në fund më 1997, kur iu vu ballë për ballë regjimit të Beogradit.

Formimi i organizatës "Komiteti Revolucionar për Bashkimin e Kosovës me Shqipërinë"

Organizata "Komiteti Revolucionar për Bashkimin e Kosovës me Shqipërinë" u formua në muajin maj të vitit 1960. Duhet cekur se vitet e '50 e '60 ishin vite shumë të rënda për shqiptarët që kishin ngelur nën Jugosllavi. Në këtë gjendje ndikim të dukshëm kishte luajturi edhe prishja e marrëdhënies në mes të grupit të shteteve socialiste dhe Jugosllavisë, siç njihet ndryshe koha e Informbyrosë. Duke e ndier robërinë edhe më tepër mbi kurrizin e popullit, disa

intelektualë kishin marrë përsipër që ta formonin një organizatë ilegale të cilën e pagëzuan me emrin shumë simbolik dhe transparent për qëllimet e tyre Komiteti Revolucionar për Bashkimin e Kosovës me Shqipërinë. Emri i organizatës kishte të bënte edhe me vetë programin e saj, i cili kishte të bënte me bashkimin e të gjitha tokave shqiptare që ishin okupuar nga Jugosllavia që t'i bashkoheshin Shqipërisë.

Organizatorët dhe themeluesit e organizatës ishin: Kadri Halimi, Ali Aliu dhe Ramadan Hoxha. Që të tre edhe më herët kishin qenë të përndjekur politikisht (1952-1954) dhe kishin përjetuar kuluaren e burgjeve të Goli Otokut si Kadri Halimi e Ali Aliu, ndërsa Ramadan Hoxha kishte qenë në Burgun e Mitrovicës së Sremit. Sipas të dhënave që i ka lënë atdhetari Kadri Halimi, thuhet se "de jure" organizata nuk u themelua, porse në terren u themeluan degët e saj. Nuk u zgjodh asnjëherë kryetari i saj, porse që të tre themeluesit e saj ishin udhëheqës të saj. Organizata kishte marrë qëndrim që në takimet e tyre të shpeshta që i mbanin që të trajtohen tema dhe të merren qëndrimet kryekëput të karakterit kombëtar dhe në terren të ketë shtrirje të gjerë si në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi si dhe në Serbi (Medvegjë, Preshevë e Bujanoc).

Veprimtaria e kësaj organizate u zhvillua kryesisht në formë treshesh dhe në bazë të dokumenteve shihej se kishte një numër të konsideruar anëtarësh. Edhe kjo, sikurse edhe organizatat e tjera ilegale, kishte programin e vet që kryesisht e mbështeste në kërkesat e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, të Lidhjes së Pejës, Konferencës së Bujanit dhe të Organizatës Nacional Demokratike Shqiptare.

Pasi ishte themeluar organizata, në mbledhjet e mëvonshme që u mbanin u bisedua shtruar se në çfarë forme dhe në çfarë mënyre do të bëhej organizimi i saj. U mor qëndrimi që në lagjet e qyteteve dhe nëpër fshatra të organizohen grupe të veçanta që do t'i anëtarësonin anëtarët aty edhe ku vepronin, ndërsa nëpër komuna do të formoheshin këshilla apo komitete të rretheve. Të tëra këto përgatitje bëheshin me qëllim që kur të kryhej ky organizim, në të gjitha trevat shqiptare do të thirrej Konferenca apo Kuvendi i Përgjithshëm si organ përfaqësues i organizatës.

Organizatorët e organizatës ishin të mendimit se pasi të zgjidhen përfaqësuesit nga

komunat e rrethet ku ishin formuar komitetet, përfaqësuesit e tyre do të merrnin pjesë në Kuvend dhe udhëheqësja e ngushtë e kryetari i saj do të zgjidheshin me vota të fshehta, por deri në atë kohë organizata do të udhëhiqej nga një organ i përkohshëm që do të quhej Komiteti Revolucionar për Bashkimin e Kosovës me Shqipërinë.

Është për t'u habitur se në dokumentet e proceseve gjyqësore më ka rënë të lexoj se organizata ilegale atdhetare, kishte një emër pak më ndryshe, ngase në dokumente thuhej se ajo e kishte emrin Organizata Antirevizioniste për Bashkimin e Kosovës me Shqipërinë dhe kishte për qëllim bashkimin e tokave shqiptare me Shqipërinë.

Në mbledhjet e shumta që kishin mbajtur më vonë, në bazë të dokumenteve thuhej se ata ishin përgatitur që të paraqisnin disa kërkesa imediate, sendërtimi i të cilave parashikohej në perspektivë.

Veprimtaria atdhetare e Mulla Nuredin Maxherës në Organizatën Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve (ORBSH)

E thamë edhe më herët se pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, Kosova ngeli nën okupimin serbo-sllav, andaj atdhetarët e shumtë nuk u pajtuan me këtë fat, por ata pa hezituar u aktivizuan në organizata të shumta atdhetare ilegale. Po këtë rrugë të atdhedashurisë e vazhdoi edhe hoxha atdhetar, Mulla Nuredin Maxherja, i cili iu bashkua atdhetarëve - miqve të vet siç ishte Kadri Halimi, Ali Aliu, Ramadan Hoxha e atdhetarë të tjerë.

Pas shumë aktiviteteve e veprimeve atdhetare ilegale, organizatorët e organizatës zbulohen, arrestohen, burgosen dhe dënohen me shumë vite burg. Gjithashtu, pa kaluar një kohë e gjatë zbulohet dhe arrestohet edhe grupi i Mulla Nuredin Maxherës, i cili përbëhej prej tetë vetave.

Më 13 tetor 1961, në Gjykatën e Qarkut të Vrajës, mbahet procesi gjyqësor të cilin e udhëhoqi kryetari i trupit gjykues Dragutin Nikoliqi. Në librin e tij atdhetari Kadri Halimi shkruan se në pyetjen e parë e provokuese që i bëhet hoxhës nga ana e gjykatës ishte:

- Gjykatësi: Thuaje të vërtetën se a shkruan në Kuran se Zoti është një dhe i pari, kurse pushteti i dyti, dhe ai që ngre dorë kundër pushtetit është i

pabesë e i pabesim?

Mulla Nuredini i përgjigjet: Po, por kundër cilit pushtet? Sikur të kisha çu dorë kundër pushtetit tim shqiptar, do të më gjykonin Perëndia dhe populli. Unë veprova kundër pushtetit të huaj, atij jugosllav, e për këtë Zoti dhe populli do të më lavdërojnë.

Pas këtij dialogu në gjykatore, kryetari i trupit gjykues, pas komunikimit të aktgjykimit, e pyet hoxhën se a është i kënaqur me lartësinë e dënim-it. Hoxha i përgjigjet se i vjen keq që nuk ka mundur të punojë edhe më tepër për popullin e vet.

Në këtë proces gjyqësor u dënuan tetë veta:

1. Mulla Nuredin Xhemali-Maxhera - Malësia e Karadakut, 2 vjet e 6 muaj burgim të rëndë, (në një shkrim tjetër e kam hasur se Mulla Nuredini dënohet me 8 vjet burgim, ngaqë kjo më dukej edhe më e përafërt, meqë Mulla Nuredini arrestohet e dënohet në vitin 1961, ndërsa lirohet nga burgun në prill të vitit 1969)
2. Ali Xhelili-Ilincë, 3 vjet e 6 muaj burgim të rëndë
3. Fevzi Aliu- Preshevë, 3 vjet burgim të rëndë
4. Tefik Haxhia, Geraj i Preshevës
5. Zahir Sakipi-Golemidol, 1 vjet burgim i rëndë
6. Nuredin Aliu- Preshevë, 3 vjet burgim të rëndë
7. Jetish Jetishi-Depecë, 1 vjet burgim i rëndë
8. Hetem Ajdini-Sefer - Komuna e Preshevës, 1 vjet burgim i rëndë

Duhet theksuar se gjatë qëndrimit në burg, gjatë hetuesisë, hetuesit, edhe pse përdorën metodat më të rënda ndaj hoxhës dhe shokëve të tij, ai qëndroi i patrembur dhe në asnjë çast nuk tregoi shokët. Andaj, po nga këto tortura, atdhetari u sëmurë rëndë. Pasi lirohet nga burgun, në muajin prill, më 1969, në muajin qershor ai mbyll sytë, me mallin dhe dashurinë e madhe që kishte për vendin e që e la nën robëri skllavëruese. Ai mbylli sytë për të mos vdekur kurrë!

U varros me nderimet më të larta nga bashkëkombësit e vet që i desh shumë dhe që nuk kurseu asgjë për lirinë e vendit. U varros në praninë e shumë qytetarëve të ardhur nga të gjitha anët e Kosovës dhe më gjerë. Populli gjithmonë do ta kujtojë me pietet figurën e ndritur të hoxhës - atdhetar, duke ngritur lapidarë për të dhe duke ruajtur kujtimet më sublime për qëndresën e tij.

I lehtë i qoftë dheu i atdheut!
(Fusnotat i ka hequr redaksia)





| Autor: GAZMEND MORINA | | | | | | BANOR I NJË SHTETI SKANDINAV | E FRIKËSOJ SHUMË DIKË | QYTET NË SHQIPËRI | AGIMI (perkdh.) | AKTORI ... HANKS (shq.) | EPOKA ERE | ZVOGËLIM I TEPËRT (shq.) | ZANORE | RIFAT AVDIU | AKTORJA ISMAILI | FAJDEXHI | | |
|--|--|--|--|--|--|----------------------------------|---|--------------------------|--|--|---|---------------------------------|-------------------------------------|---|------------------------|--|--|------------------------|
| DISKUTIM I GJERË | | | | | | | | | | | KURESHTJE KRYEQYTETI I MAROKUT (pashq.) | | | | | | | |
| METAFORË E GJATË | | | | | | | | | | | | | TENISTJA KURNIKOVA ELIZABETH TAYLOR | | | | | |
| SHKRIMTARJA KAMBERI | | | | | | | | | | | | | | ISMET MUNISHI QË KA TË BËJË ME PARAARDHËSIT TANË | | | | |
| SOLISTJA ... BYTYQI | | | | | | | | | I MBAROVA, I PËRFUNDOVA (bised.) I SKALITA | | | | | | | | | |
| NJË E PANJOHUR NË MATEMATIKË | | | | | | | | | | ARBEN MALAJ PUNËTOR I TEATRIT TË KUKULLAVE | | | LATINISHT (shk.) QË VUAN NGA MANIA | | | | | |
| EPOKA ERE | | | | | | BASHKËT. LËGJENDË (sh.pashq.) | | TË LATUARIT HARK, KTHESE | | | | | | | ZANORE ANTIGONA SEJDIU | | | |
| KLUB FUTBOLLI NË ITALI | | | | | | | | | | | DËM, PRISHJE; HUMBJE | | | | | | | |
| EPOKA ERE | | | | | | KËNGËTARJA NË FOTO | BASHKËP-UNËTOR | POLITIKANI SUEDEZ BILD | LETRARI I SHQUAR HEMINGWAY | TIANTERA (shk.) | CILI ME RADHË REP GRUP ".... ENGUJIT" | REGJISORJA SHQIPTARE GJONI | | | | SHKRONJË GREKE | | |
| MODEL I ZVOGËLUAR I NJË PROJEKTI (SH.SHQ.) | | | | | | | | | | | KNOWLEDGE OASIS MUSCAT DISIPLINË SPORTIVE | | | SHOK VLERË, DOBI (krah.) | | BASHKËTIN-GËLLORE KËNGËTARI SHAQIRI | | |
| E QESHUR TALLËSE | | | | | | | | | | | | | | DEM, TER PULËDETI (sh.shq.) | | | | |
| ISH FUTBOLLISTI ARGJENTINAS KRESPO (CHELSEA, INTER) | | | | | | | | | | PIKTORI VALLA (shq.) HOV, VRULL | | | | METAL I FORTË ME NGJYRË HIRI LUTJE QË I BËHET ZOTIT (mysl.) | | | | |
| → | | | | | | | | | | | | | | ARMATA REPUBLIKANE IRLANDEZE (shk. origj.) DASHUROR | | | | |
| GOJORE ISMET TOTO | | | | | | | | | | | | | | | | FUTBOLLISTI ITALIAN IGNAZIO (MILAN) | | |
| BASHKËT. | | | | | | | BANORET E ATIKËS TRUP QIELLOR (sh.shq.) | | | | | | | | | | | |
| ECLIPSE PUBLIC LICENSE | | | | | | | | | | | | | | SEKRETARI I OKB-së BAN KI ... TËRËSORE | | DEPARTAMENT OF TRANSPORT. SHTAGAT | BASHKËT. RACË DHENSH ME PREJARDHJE NGA AFRIKA E VERIUT | |
| BLERTËRR-ITËS | | | | | | | | | | | | | | | | MARK ANTONI KOHË | | |
| SHKËMB I PËRBËRË PREJ RËRE TË NGJESHUR | | | | | | | | | | | "KENIA" SANACION, PËRMIRËSIM | | | | | INATOSJET ISMET HYSA | | |
| AKUZUES I SOKRATIT | | | | | | | | | | | KONFERENCË ME KARAKTER NËRKOMB-ËTAR (sh.shq.) SHEGA | | | | | PJESË E FORTË E BUKËS REGJISORI I FAMSHËM ... BURTON | | |
| HERMAN EDUARDSON | | | | | | | | | | | VENDËS PËRËMËR VETOR | | | | | FUTBOLLISTI TURK ALTINTOP AUSTRALIAN PROPERTY MONITORS | TITAN KRAHINË NË SHQIPËRI | EPOKË (shq.) |
| KLUB FUTBOLLI NË ITALI | | | | | | | | | | | | | | | | OLIVIA ANDERSON | MBAJTJE E ANËS DY BASHKËTINGËLLORE | NEON TAJVANI, INDIA |
| EPOKA ERE | | | | | | SHTRESA E SIPËRME E AJRIT ZANORE | | | | | | | | | | SKAJ MAGNETIK ZANORE | | FILLESTAR EVERTON |
| ORGANIZATË GUERILE NË SPANJË | | | | | | | | | | | | | | | | | | LUMË I MADH NË HUNGARI |

Kamy është vrarë nga KGB-ja!?

Gjashtëdhjetë vjet pasi laureati francez i çmimit Nobel për Letërsi vdiq në një aksident automobilistik në moshën 46-vjeçare, një libër i ri pretendon se ai u vra nga spiunët e KGB-së në shenjë hakmarrjeje për retorikën e tij anti-sovjetike, transmeton Telegrafi.

Autori italian Giovanni Catelli e publikoi për herë të parë teorinë e tij më 2011, duke shkruar në gazetën "Corriere della Sera" se kishte zbuluar detaje në ditarin e poetit dhe përkthyesit të njohur çek, Jan Zábřana, që shoshte se vdekja e Kamysë (Albert Camus) nuk ishte aksident. Catelli ka zgjeruar kërkimet e tij në librin "Vdekja e Kamysë".

Kamy vdiq më 4 janar 1960 kur botuesi i tij Michel Gallimard humbi kontrollin e makinës dhe ra në një pemë. Autori vdiq menjëherë; Gallimard disa ditë më vonë. Tre vjet më parë Kamy kishte fituar Nobelin për "ndriçimin e problemeve të

ndërgjegjes njerëzore të kohëve tona".

Catelli citon një fragment në ditarët e Zábřanas: poeti shkroi në fund të verës së vitit 1980 se "një njeri i ditur dhe me lidhje" i kishte thënë atij se duhet të fajësohet KGB-ja, agjentët e së cilës i kanë shkaktuar dëmet në veturë të cilat në shpejtësi të madhe u bënë fatale. Urdhri thuhet të jetë dhënë nga Dmitri Shepilov, ministër sovjetik i Punëve të Brendshme, si reagim ndaj një artikulli që Kamy ka shkruar më 1957 në gazetën "Franc-Tireur" në mars 1957.

"Janë dashur tri vite që të merret vendimi", thuhet në ditarin e Zábřanas.

Kamy ia kishte mbajtur anën kryengritjen hungareze të vjeshtës 1956 dhe ishte kritik ndaj reagimit sovjetik. Ai po ashtu kishte shkruar mirë për Boris Pasternakun që shihej si anti-sovjetik.

Catelli ka kaluar tri vite duke hulumtuar pretendimet e



Zábřanas. E ka intervistuar gruan e tij, agjentët e mëparshëm të KGB-së në Francë, dhe ka dëshmi të dorës së dytë nga avokati kontrovers, Jacques Vergès, që ia kishte dhënë banakierit Giuliano Spazzali pas vdekjes së Kamysë.

"Vergès tha se aksidenti ishte inskenuar", ka thënë Spazzali. Catelli pretendon se zëri i Kamysë ndërhynte në marrëdhëniet franko-sovjetike dhe se "karakteri i Kamysë në sytë e popullit ishte përkujtues i mizorisë së BRSS-së, për çka si

qeveria franceze ashtu edhe ajo sovjetike do të kishin përfituar nga heshtja e këtij përkujtuesi të pakëndshëm, ndaj asnjë hetim i duhur nuk u krye". Catelli thotë se këtë teori nuk e mbështet vajza e Kamysë, Catherine. /Telegrafi/

VITET

Nga: Cesare PAVESE
Përktheu: Renato KALEMI

Prej atij që kam qenë atëherë nuk ka mbetur më asgjë: ende jo burrë, isha një fëmijë. E dija prej kohësh, por gjithçka ndodhi në fund të dimrit, një mbrëmje e një mëngjes. Ishim bashkë, thuajse të fshehur, në një dhomë që shihte për nga shëtitortja. Atë natë Silvia më tha se duhej të largohesha, ose do të largohej ajo – nuk kishim ç'të bënim më bashkë. Iu përgjérova që ta provonim sërish; isha shtrirë përkrah saj dhe e përqafoja. Ajo më tha: – E për çfarë? – Flisnim me zë të ulët, në errësirë. Pastaj,

Silvian e kapiti gjumi, ndërsa unë e mbajta njërin gju ngjitur me të sajën, deri në mëngjes.

Mëngjesi u shfaq siç qe shfaqur gjithmonë, dhe bënte shumë ftohtë; Silvias i kishin rënë baluket përmbi sy dhe nuk lëvizte. Unë shihja kohën teksa kalonte në gjysmëhije, e dija se kalonte dhe vraponte, dhe se jashtë kishte rënë mjegulla. E gjithë koha që kisha kaluar me Silvian në atë dhomë, ishte si një ditë-natë e vetme, e cila po mbaronte tani në mëngjes. Atëherë e kuptova se nuk do të dilnim kurrë së bashku në mjegullën e freskët. Do të bëja mirë të vishesha e të ikja pa e zgjuar. Por, tani kisha në mend-

je ta pyesja edhe për diçka tjetër. Prita, duke u përpjekur të merrja një sy gjumë.

Kur u zgjua, Silvia më dhuroi një buzëqeshje. Filluam të flisnim. Ajo tha: – Është bukur të jesh i sinqertë si ne. – Oh Silvia, – i pëshpërita – çfarë do të bëj kur të dal që këtej? Ku të shkoj? – Për këtë doja ta pyesja. Ajo qeshi sërish, lumturisht, pa e lëvizur kokën nga jastëku. – Budalla, – më tha – do të shkosh ku të duash ti. A nuk është bukur të jesh i lirë? Do të njohësh shumë vajza, do të bësh ç'të duash. Diçka, për të cilën të kam zili. Tani mëngjesi mbushte dhomën dhe veçse shtrati kishte ruajtur pak ngrohtësi. Silvia priste e duruar. – Ti je si një prostitutë, – i thashë, – dhe gjithmonë ke qenë e tillë. Silvia nuk i hapi sytë. – Ndihehsh më mirë tani që e the? – më tha. Atëherë u mbështeta sikur ajo të mos ishte aty, vështroja tavanin dhe qaja në heshtje. Lotët më mbushnin sytë dhe më rridhnin poshtë faqeve.

Nuk ia vlente që ajo ta dinte këtë. Ka kaluar shumë kohë dhe tani e di se ato lot të heshtur qenë e vetmja burrëri që tregova me Silvian; e di se qaja jo për të, por sepse kisha parashikuar fatin tim. Prej atij që isha atëherë nuk ka mbetur më asgjë. Mbeti vetëm se e kisha kuptuar kush do të isha në të ardhmen.



Pastaj, Silvia më tha: – Tani mjaft! Duhet të ngrihem. U ngritëm bashkë, të dy. Nuk e pashë teksa vishej. U ngrita shpejt në këmbë, në dritare, shihja lulet që çelnin. Pas mjegullës fshihej dielli, ai diell që kishte përshkuar kaq herë dhomën. Edhe Silvia u vesh shpejt dhe më pyeti nëse do t'i merrja me vete gjërat e mia. I thashë se më parë doja të bëja një kafe dhe nderza furnelën. Silvia, e ulur në cepin e shtratit, nisi t'i ngjyoste thon-

jtë. Më parë i kishte bërë gjithmonë në tavolinë. Dukej e menduar dhe flokët i binin vazhdimisht mbi sy. Atëherë bënte një lëvizje me kokë dhe çliruhej prej tyre. Unë u vërdallosa nëpër dhomë t'i mblidhja gjërat e mia. Bëra një grumbull mbi karrige, kur për një çast Silvia u ngrit dhe vrapoi ta hiqte kafënë që po derdhej.

Pastaj nxora valixhen dhe futa teshat. Ndërkaq, brenda përpiqesha t'i mblidhja të gjitha

kujtimet e këqija që kisha me Silvian – kotësitë, gjendjet e mërzitshme, fjalët acaruese, rrudhat. Këto po merrja nga dhoma e saj.

Ajo çfarë lija ishte një mjegull. Kur mbarova, kafeja ishte gati. E pimë në këmbë, pranë furnelës. Silvia diçka tha, se do të shkonte tek një tip për të folur për një punë. Pas pak, lashë filxhanin dhe u largova me valixhen. Jashtë mjegulla dhe dielli t'i qorronin sytë. /Revista "Akademia"/

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Kërkohet qetësi dhe bashkim para ndeshjeve historike

Ish-kryetarët e FFK-së, Agim Bytyçi, Sabri Hashani dhe ish-përzgjedhësit e Përfaqësues së Kosovës, Ajet Shosholli, Bylbyl Sokoli, Edmond Rugova, Albert Bunjaki, si dhe ndihmëstrajneri aktual Muharrem Sahiti, kanë kërkuar qetësi dhe të gjithë të janë bashkë para ndeshjeve historike që Kosova i zhvillon në muajin mars në rrugëtimin drejt kualifikimit historik në Kampionatin Evropian



PRISHTINË, 11 DHJETOR (ER) - Ish-kryetarët e Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Bytyçi e Sabri Hashani dhe ish-përzgjedhësit e Përfaqësueses së Kosovës, Ajet Shosholli, Bylbyl Sokoli, Edmond Rugova, Albert Bunjaki dhe ndihmësi i Bernard Challandesit, Muharrem Sahiti, janë pritur të mërkurën në një takim nga kryetari aktual i FFK-së, Agim Ademi dhe sekretari i përgjithshëm, Eroll Salihu.

Kryetari Ademi Ademi falënderoi të gjithë protagonistët e periudhave të ndryshme për kontributin e madh që kanë dhënë për futbollin e Kosovës. "Përfaqësuesja po na bën krenarë të gjithë neve dhe ka arritur ta sjellë futbollin tonë në pikën më të lartë prej ekzistimit të tij. Falë rezultateve të 'dardanëve' dhe punës sonë kemi arritur që futbollin ta kthejmë në sport familjar, ku njerëzit i shtojnë edhe obligimet e tyre kur luan Përfaqësuesja, e cila po i jep kënaqësi mbarë kombit. Ndihejmë i nderuar që jam në krye të këtij institucioni, por e them me sinjeritet të plotë se këto suksese nuk janë rezultat vetëm i punës sonë të tanishme, por meritat janë të të gjithë atyre që në periudha të ndryshme kohore kanë dhënë kontributin e tyre në FFK dhe në futbollin

e Kosovës. Pra, sikur të mos ishte koha e mbijetesës, të cilën unë e quaj të artë, dhe që është unike, sepse nuk ka ndodhur askund tjetër në botë që për aq shumë vite në kushte të okupimit të bëhet një organizim i tillë, ne do ta kishim shumë më të vështirë të arrinim ku jemi sot", ka thënë Ademi. Kryetari i parë i FFK-së, Agim Bytyçi, u shpreh falënderues ndaj drejtuesve të federatës për respektin që po e ruajnë në vazhdimësi për ata që në të kaluarën e dhanë kontributin e tyre për formësimin e kësaj federate dhe të ekipit përfaqësues të Kosovës. Edhe ish-kryetari Sabri Hashani u shpreh mirënjohës për respektin që po tregojnë drejtuesit aktualë të FFK-së, kurse i përgëzoi ata për sukseset e deritanishme. Ish-përzgjedhësi i Kosovës, Ajet Shosholli, ka thënë se populli që nuk e rikujton dhe respekton të kaluarën nuk ka ardhmëri. Sipas tij, është për t'u vlerësuar respekti që drejtuesit aktualë të FFK-së kanë për gjeneratat e mëparshme. Ish-përzgjedhësi tjetër i Kosovës, Bylbyl Sokoli, pasi foli për të kaluarën, ka thënë se është e nevojshme që nga ky takim t'u bëhet thirrje të gjithëve se nuk është koha e destabilizimit të federatës. "Ditët e fundit në shtet dhe informimit e kemi shumë të shprehur përpjekjen për stabilitet në

FFK dhe kjo e dëmton shumë futbollin tonë. Nuk dua të përcaktohem se kush ka të drejtë apo nuk ka, por duhet ta kemi parasysh se këto debate ndikojnë në harxhimin e energjisë dhe e dëmtojnë mobilizimin tonë para dy ndeshjeve historike që do t'i luajë Kosova në muajin mars. Andaj, vlerësoj se e kemi obligim të gjithë ne që kemi dhënë kontribut nëpër periudha të ndryshme, që të bëjmë thirrje për qetësim të situatës sepse jemi në një periudhë të ndjeshme dhe kjo reflekton tek ekipi kombëtar dhe mund ta dëmtojë synimin tonë. Situatat si këto që ishin ditët e fundit e ndihmojnë vetëm Maqedoninë e Veriut, e cila lehtë mund të kualifikohet tutje pa lojë, por njëherësh i shkojnë përshtati edhe Serbisë, e cila vazhdimisht kundërshtimin e saj e ka përqendruar në atë se Kosova nuk di të mbajë institucione", ka deklaruar Sokoli. Edhe dy ish-përzgjedhësit e tjerë, Edmond Rugova dhe Albert Bunjaki, të cilët kanë falënderuar drejtuesit aktualë të federatës për respektin, kanë kërkuar që të ruhet qetësia dhe të gjithë të janë të bashkuar para dy ndeshjeve historike për Përfaqësuesen e Kosovës, e cila mund ta shkruajë historinë duke u kualifikuar në Kampionatin Evropian.

SHKURT

Nora, Distria dhe Akili përfaqësojnë Kosovën në Kinë

Tre xhudistë nga Kosova do të jenë pjesë e garës së fundit për këtë vit "World Judo Masters" që mbahet në Qingdao të Kinës. Federata e Xhudos e Kosovës njofton se kjo garë është e fundit për këtë vit në kalendarin e garave të IJF dhe EJU, kurse në të marrin pjesë 32 xhudistët e parë të radhitur në ranglistën botërore të Federatës Botërore të Xhudos në secilën kategori. Distria Krasniqi (-48kg) që në ndeshjen e parë takohet me fituesen e ndeshjes ndërmjet brazilianes Gabriela Chibana dhe gjermanes Katharina Menz. Nora Gjakova (-57kg) në ndeshjen e parë takohet me koreanen Jisu Kim, kurse Akil Gjakova (-73kg) në ndeshjen e parë takohet me garuesin nga Gjermania, Anthony Zingg. Distria Krasniqi dhe Nora Gjakova garojnë të premtën, kurse Akil Gjakova të shtunën.

Batatina nuk heq dorë nga titulli

Tahir Batatina nuk mendon për mbijetesë, ani pse Llapi i tij është më pranë zonës së rrezikshme për titullin kampion. "Do të përpiqemi t'i sjellim të paktën katër përforcime serioze dhe më pas të shohim në pranverë se çka do të ndodhë. Duhet ta dimë që në stinorin pranveror do të luhen edhe 16 ndeshje dhe lufta për titull nuk është mbyllur ende", ka thënë Batatina për "Olle".

Sokoli, në bisedime me Flamurtarin

Trajneri i njohur në futbollin e Kosovës, Bylbyl Sokoli, është në bisedime me Klubin e Flamurtarit nga Prishtina. Bisedimet në mes të "Profes" dhe klubit kuqezi kanë avancuar dhe marrëveshja mund të bëhet zyrtare sot (e enjte). Skuadra e Flamurtarit sezonin vjeshtor e mbylli në pozitën e nëntë me 19 pikë.

Aston Villa ofron 33 milionë euro për Rashicën

Pasi që u raportua se dy skuadrat e mëdha italiane, Napoli dhe Milani, janë interesuar për shërbimet e Milot Rashicës, gjatë ditës së mërkurë mediat angleze raportojnë rreth ofertës së Aston Villës. Skuadra angleze ka ofruar 33 milionë euro për Milot Rashicën, mirëpo drejtori sportiv i Werder Bremenit, Frank Baumman, ka bërë me dije se ylli i Kosovës nuk e ka ndërmend të largohet nga Werderi gjatë afatit kalimtar të janarit. Rashica ka shënuar tetë gola këtë sezon me skuadrën gjermane.

Rexhbecaj, afër Hannoverit

Mesfushori me prejardhje nga Kosova, Elvis Rexhbecaj, që paraqitet në radhët e Wolfsburgut, gjatë vitit 2019 ka humbur minutat, duke u paraqitur shumë pak për skuadrën nga Bundesliga. Sipas 'Fu Meister', 21-vjeçari pritet të kalojë te Hannover 96 në Bundesliga 1. Te Hannoveri Rexhbecaj do ta gjejë Florent Muslijjan, mesfushorin e Kombëtares së Kosovës. Siç raportohet, për Rexhbecajn janë të interesuara edhe Baseli, Freiburgu, Kolni dhe Norwichi. Rexhbecaj është nga Komuna e Prizrenit dhe ai ende ka mundësinë të zgjedhë për ta përfaqësuar Kosovën.

Ferrari: Humbëm titullin pa nisur sezoni

ROMË, 11 DHJETOR - Drejtori sportiv i Ferrarit, Mattia Binotto, ka thënë se ai nuk priste që makina italiane ta fitonte titullin kampion këtë sezon. Sipas tij, Ferrari e kishte humbur betejën me

Mercedesin që para se të niste sezoni. Binotto ka habitur me deklaratën se makina Ferrari nuk ishte mjaftueshëm e mirë për të dueluar me Mercedesin. "Mendoj se garën me Mercedesin e humbëm qëkur

u dizajnuar makina e re Ferrari. Nuk ishim kompetitivë që në fillim të sezonit", ka thënë Binotto. "Projekti i Ferrarit 2019 nuk ishte mjaftueshëm i mirë që në startin e sezonit. Gjithashtu,

edhe zhvillimi gjatë sezonit nuk ishte ai që pritej krahasuar me rivalët. Punuam shumë, por ishte e pamundur", ka shtuar Binotto, referuar faktit që Mercedesi i fitoi 8 garat e para sezonale.



Miami dhe Philadelphia nuk ndalen, fiton edhe Portlandi

MIAMI, 11 DHJETOR - Ishin vetëm katër sfida në mbrëmjen e NBA-s, por emocionet dhe spektakli nuk munguan. Dueli më i fortë ishte ai që u zhvillua në "American Airlines Arena" të Miamit, aty ku Heats mposhti pas kohës shtesë me shifrat 135-121 Atlanta Hawksin. Për ta udhëhequr Miamin drejt fitores së 3-të radhazi dhe të 18-s sezonale mendoi treshja Nunn-Robinson-Adebayo. I pari rezultoi pikëshënuesi më i mirë i sfidës me 36 pikë, ndërkohë që Adebayo ishte thjesht fantastik me një triple-double prej 30 pikësh, 11 rikuperimesh poshtë tabelës dhe 11 asistimeve.

Skuadra nga Georgia rezistoi shumë mirë në katër periodat e kohës së rregullt të cilat u mbyllën në barazim 117-117, por Miami në 5 minutat e shtesës bëri vërtet diferencën dhe falë një rezultati të pjesshëm 18-4, fitoi bindshëm ndeshjen. U rikthye te suksesi pas dy humbjesh, Portland Trail Blazers. Në "Moda Center" të Oregonit, Damian Lillard realizoi 31 pikë në suksesin 115-87 të Portland ndaj New York Knicksit. Paraqitje pozitive edhe Carmelo Anthony ndaj ish-skuadrës së vet, me Melon që realizoi 16 pikë. Vijon forma e mirë e Philadelphia 76-



ers që mori fitoren e 8-të në 10 ndeshjet e fundit falë suksesit 97-

92 ndaj Denver Nuggetsit që në krahun tjetër vazhdon rënien e lirë. Për 76-ers më i miri mbi parket ishte i përhershmi Joel Embiid, autor i 22 pikëve, por edhe 10 reboundeve dhe 6 asistimeve. Një fitore të rëndësishme mori edhe Charlotte Hornets që kaloi me rezultatin 114-107 Washington Wizards.

REZULTATET

| | |
|------------------------|---------|
| Charlotte - Washington | 114-107 |
| Miami - Atlanta | 135-121 |
| Philadelphia - Denver | 97-92 |
| Portland - New York | 115-87 |

Pulevi, kundërshtari i radhës për Joshuan

LONDËR, 11 DHJETOR - Anthony Joshua do të duelojë në prill të 2020-s ndaj bullgarit Kubrat Pulev. Lajmin e konfirmoi Eddie Hearn, menaxheri dhe promotori i boksierit britanik. Pulev është i mandatuar nga IBE, titull të cilin e mban aktualisht Joshua. 38-vjeçari bullgar, 28 tore e vetëm 1 humbje në karrierën si profesionist (ndaj Klitschko), ka dueluar për herë të fundit më 9 nëntor, kur mundi amerikanin Rydell Booker. Ndërsa Joshua dueli të shtunën e kaluar, kur mposhti në revansh Andy Ruiz. "IBF-ja është ajo që urdhëroi e para këtë duel, ndaj Pulev është i pari në listë. Gjithsesi, do të flas fillimisht me presidentin e IBF-së, pasi i mandatuar është edhe Usyk nga kategoria WBO", ka thënë Eddie Hearn, i cili ka shtuar se pas Pulevit do të jetë radha e ukrainasit Oleksandr Usyk.



SHKURT

Conte: Kishim mundësi ta mposhtnim Barcelonën

Skuadra e Interit është eliminuar nga Liga e Kampionëve pasi humbi ndeshjen kryesore ndaj Barcelonës (1-2). Trajneri Antonio Conte ka thënë se lojtarët e Interit luajtën shumë mirë, por që u mungoi saktësia për të shënuar gol. "Ne i patëm mundësitë për ta fituar ndeshjen, i krijuam rastet, mirëpo na mungoi ajo saktësia e rëndësishme për t'i konvertuar ato raste në gola. Nuk kam asnjë ankesë, pasi që lojtarët e mi dhanë gjithçka nga vetja. Neve na mungoi një gol dhe pastaj pranuan gol në qoshen tjetër dhe ishim në deficit 2-1, që na shkatërroi me të vërtetë", ka thënë Conte. "Unë u zhgënjëva edhe për tifozët në 'San Siro', pasi që ata na nxitën që nga fillimi e deri në fund dhe e krijuan një atmosferë të mrekulueshme. Duhet të kishte përfunduar ndryshe. Mendoj se meritua më shumë nga ky grup. Por, mendoj se është një përvojë e vlefshme. Ne dëshironim të kualifikohemi, kështu që është zhgënjyese për të gjitha tani. Por, siç u thashë atyre, duhet ta ngritim kokën lart sërish", ka deklaruar Conte.

Bayerni mund t'i humbasë Thiagon dhe Mullerin

Thiago Alcantara dhe Thomas Muller po mendojnë të largohen nga Bayern Munichu qysh në afatin kalimtar të janarit. Mesfushori spanjoll nuk është i lumtur me minutat e kohës po i jep trajneri i përkohshëm, Hansi Flick, andaj e kërkon largimin. Në anën tjetër, Mulleri po luan më shumë nën urdhrat e tij, mirëpo nuk dëshiron ta presë trajnerin e ri dhe të ambientohet me strategjitë e tij. "SportBild" raporton se nga bavarezët mund të largohen edhe Manuel Neueri e Jerome Boateng që kanë kontrata deri në vitin 2021. Në javët e ardhshme pritet të mesohet më shumë për kontratat e katër lojtarëve të Bayernit.

Barça, ofertë për Velan

Sulmuesi i rrezikshëm Carlos Vela kaloi një sezon të jashtëzakonshëm me ekipin Los Angeles FC në ligën MLS. Ai mund t'i bashkohet gjigantit katalunas për pjesën e dytë të sezonit. Futbollisti Jonathan dos Santos zbulon se Carlos Vela e ka marrë një ofertë nga Barcelona pas një sezoni të jashtëzakonshëm në MLS. 30-vjeçari kishte njoftuar se është afër transferimit në "Camp Nou" për pjesën e dytë të sezonit. Vela konsiderohet zëvendësues ideal i Luis Suarezit, duke e pasur parasysh sezonin e lodhshëm dhe të ngarkuar.

Cavani larg PSG-së, afër Atletico

Sulmuesi Edinson Cavani do të largohet nga Paris Saint Germaini në sezonin e ardhshëm. Lajmi raportohet nga "France Football" që ka zbuluar se klubi francez nuk ka ndërmend t'i ofrojë një kontratë të re, ndërkohë që aktualja skadon në qershorin e ardhshëm. Cavani ka luajtur deri tani vetëm 326 minuta në kampionat dhe Tuchel nuk e shikon më si zgjedhjen e parë dhe rrugët pritet të ndahen jo në janar, por në verë. Atletico Madridi është ekipi favorit për ta afruar uruguianin, ndërkohë që për të ka oferta edhe nga Kina apo ShBA-ja.

Napoli shkarkon Ancelottin, Arsenali dhe Evertoni 'fërkojnë' duart

Napoli është kualifikuar për në raundin e 1/16-ave, në Ligën e Kampionëve, pasi fitoi ndaj Genkut me rezultatin 4-0, Carlo Ancelotti është shkarkuar nga De Laurentis mbrëmjen e djeshme dhe tashmë italianin është pa skuadër. Nuk do të jetë shumë e vështirë për italianin të gjejë një ekip tjetër shumë shpejt, pasi emri i tij "peshon" në arenën ndërkombëtare. Mediat angleze bëjnë me dije se dy klube i janë vënë pas Ancelottit. Bëhet fjalë për Arsenalin dhe Evertonin. "Topçinjtë" shkarkuan Unay Emerynë para disa javësh dhe janë në kërkim të një trajneri të ri. Por, konkurrenca do të jetë e madhe, pasi Evertoni duket se ka nisur kontaktet më herët. Mbetet të shihet tashmë se ku do ta vazhdojë karrierën trajneri italian, që ka përvojë të madhe duke trajnuar skuadra "big".

Çmimet në fushën e Trashëgimisë

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në përputhje me Rregulloren NR.09/2016 për Dhënien e Çmimeve në fushën e trashëgimisë kulturore, shpall:

KONKURS

Për çmimet që i ndan Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në fushën e trashëgimisë kulturore. Ftohen të interesuarit që të propozojnë kandidatët për Çmimin për Veprimtari Jetësore në fushën e trashëgimisë kulturore “Dea Dardanicae”, Çmimin Vjetor për Merita të Veçanta “Shtjefën Gjeçovi”, Çmimin Vjetor për Vepër Shkencore “Zef Mirdita” dhe Çmimin Vjetor për Menaxhim Institucional “Muhamed Shukriu”.

Çmimi për Veprimtari Jetësore në Fushën e Trashëgimisë Kulturore “Dea Dardanicae”

Ky Çmim u jepet personaliteteve të shquara, profesionistëve të dalluar, të cilët me angazhimin e tyre të vazhdueshëm kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë në avancimin e trashëgimisë kulturore si dhe kanë nxitur të arriturat në mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të Kosovës.

Laureatë të këtij çmimi mund të jenë profesionistët, studiuesit dhe hulumtuesit në fushën e trashëgimisë kulturore, shtetas të Republikës së Kosovës dhe shtetas të vendeve të tjera.

Çmimi Vjetor për Merita të Veçanta “Shtjefën Gjeçovi”

Ky Çmim u jepet personaliteteve të dalluara në fushën e trashëgimisë kulturore, për angazhimin, kontributin dhe të arriturat përgjatë vitit për përmbushjen e detyrimit kushtetues dhe ligjor për mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të Kosovës.

Laureatë të këtij çmimi mund të jenë profesionistët, studiuesit dhe hulumtuesit në fushën e trashëgimisë kulturore, shtetas të Republikës së Kosovës dhe shtetas të vendeve të tjera.

Çmimi Vjetor për Vepër Shkencore “Zef Mirdita”

Ky Çmim u jepet autorëve për vepër shkencore në fushën e trashëgimisë kulturore.

Laureatë të këtij çmimi mund të jenë profesionistët, studiuesit dhe hulumtuesit në fushën e trashëgimisë kulturore, shtetas të Republikës së Kosovës dhe shtetas të vendeve të tjera.

Çmimi Vjetor për Menaxhim Institucional “Muhamed Shukriu”

Ky Çmim u jepet udhëheqësve të institucioneve dhe punonjësve të institucioneve publike dhe jopublike që në mandat kanë mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore.

Laureatë të këtij çmimi mund të jenë udhëheqësit dhe punonjësit e institucioneve publike dhe jopublike të institucioneve të trashëgimisë kulturore shtetas të Republikës së Kosovës.

Vlerësimin për dhënien e çmimeve e bën juria profesionale.

Konkurrimi për Çmimet në fushën e trashëgimisë kulturore mund të bëhet përmes propozimit nga:

Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës (për tri çmimet e para);

Institucionet e trashëgimisë kulturore;

Institutet shkencore, arkivat, muzetë;

Fakultetet e universiteteve publike si dhe private të Republikës së Kosovës;

Shoqatat dhe organizata që merren me trashëgimisë kulturore;

Personat fizikë dhe juridikë.

Propozimi duhet të përmbajë:

- Dokumentacion personal (kopje e dokumentit identifikues);
- Biografia me fokus në veprimtarinë për të cilin çmim nominohet;
- Dëshmitë relevante për kontributet e publikuara të të nominuarve (abstraktet e publikimeve nga fusha për të cilën nominohen, dëshmia dhe përmbajta e projekteve profesionale apo shkencore, vlerësimet dhe rekomandimet për kontribut në menaxhimin institucional në fushën për të cilën nominohet).

Propozimi duhet të nënshkruhet nga titullari që ka të drejtën e propozimit.

Propozimet me shkrim duhet të dërgohen deri me 3 Janar 2020 në adresën: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit /Departamenti Trashëgimisë Kulturore, Zyra Nr. 22 Adresa : Sheshi “Nëna Terezë” Nr. 35, Prishtinë

Rregulloren mund ta gjeni në web faqen e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit: www.mkrs-ks.org

Nagrade iz oblasti kulturne baštine

Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta, u podudarnosti sa Pravilnikom e BR.09/2016 za Dodelu Nagrada iz oblasti kulturne baštine, objavljuje:

KONKURS

Za nagrade koje dodeljuje Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta iz oblasti kulturne baštine. Pozivaju se zainteresovani da predlože kandidate za Nagradu za Životno Delo iz oblasti kulturne baštine “Dea Dardanicae”, Godišnje Nagrade za Posebne Zasluge “Shtjefën Gjeçovi”, Godišnje Nagrade za Naučno Delo “Zef Mirdita” i Godišnje Nagrade za Institucionalno Upravljanje “Muhamed Shukriu”.

Nagrada za Životno Delo iz oblasti Kulturne Baštine “Dea Dardanicae”

Ova se nagrada dodeljuje istaknutim ličnostima, istaknutim profesionalcima, koji su, svojim stalnim angažovanjem imali direktan uticaj u unapređenju kulturne baštine kao i, podstakli dostignuća u zaštiti, očuvanju i promovisanju kulturne baštine Kosova.

Laureati ove nagrade mogu biti profesionalci, naučnici i istraživači iz oblasti kulturne baštine, državljani Republike Kosova i državljani ostalih zemalja.

Godišnja nagrada za Posebne Zasluge “Shtjefën Gjeçovi”

Ova se nagrada dodeljuje istaknutim ličnostima iz oblasti kulturne baštine, za angažovanje, doprinos i dostignuća tokom godine, za ispunjavanje ustavnih i zakonskih obaveza za zaštitu, očuvanje i promovisanje kulturne baštine Kosova.

Laureati ove nagrade mogu biti profesionalci, naučnici i istraživači iz oblasti kulturne baštine, državljani Republike Kosova i državljani ostalih zemalja.

Godišnja nagrada za Naučno delo “Zef Mirdita”

Ova se nagrada dodeljuje autorima za naučno delo iz oblasti kulturne baštine.

Laureati ove nagrade mogu biti profesionalci, naučnici i istraživači iz oblasti kulturne baštine, državljani Republike Kosova i državljani ostalih zemalja.

Godišnja nagrada za Institucionalno Upravljanje “Muhamed Shukriu”

Ova se nagrada dodeljuje rukovodiocima institucija i radnicima javnih institucija koji u svom mandatu imaju zaštitu, očuvanje i promovisanje kulturne baštine.

Laureati ove nagrade mogu biti profesionalci, naučnici i istraživači iz oblasti kulturne baštine, državljani Republike Kosova i državljani ostalih zemalja.

Procenjivanje o dodeli nagrada vrši profesionalan žiri.

Konkuranje za Nagrade iz oblasti kulturne baštine mogu da se izvrše preko predlaganja od:

Akademije Nauke i Umetnosti Kosova (za tri prve nagrade);

Institucija kulturne baštine;

Naučnih Instituta, arhivat, muzeja;

Javnih fakulteta i univerziteta Republike Kosova;

Društava i organizacija koja se zauzimaju kulturnom baštinom;

Fizičkih i pravnih lica.

Predlog treba da sadrži:

- Ličnu dokumentaciju (kopija dokumenta za identifikovanje);
- Biografij sa fokusom na delatnosti za nagradu za koju se nominira;
- Relevantne dokaze za objavljene doprinose nominiranih (objavljeni abstrakti za oblast za koju se nominiraju, dokaz i sadržaj profesionalnih ili naučnih projekata, ocenjivanja i preporuke za institucionalno upravljanje iz oblasti za koju se nominira).

Predlog treba da se potpiše od titulara koji ima pravo na predlaganje.

Pismeni predlozi mogu da se pošalju do 3 Januara 2020 na adresu: Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /Departman Kulturne Baštine, kancelarija br. 22 Adresa : Trg “Majke Tereze” br. 35, Priština

Pravilnik u web stranici Ministarstva, Kulture, Omladine i Sporta www.mkrs-ks.org



FEDERATA E SINDIKATAVE TË SHËNDETËSISË SË KOSOVËS

Shpallë konkurs:
Pozita 1: Zyrta/e Ligjor,
Vendi: Prishtinë

Detyra dhe përgjegjësitë :

- Jep këshilla juridike nga legjislacioni i punës,
- Ofron ndihmë në përpilimin e mjeteve juridike për mbrojtjen e të drejtave (ankesa, kërkesa, parashtrës, njoftime, padi, etj)
- Sipas kërkesës dhe udhëzimeve të nivelit të lartë jep opinione ligjore të akteve normative si dhe akteve tjera juridike të cilat dalin nga fushë veprimtaria e institucionit,
- Bënë përfaqësim në procedurat disiplinore, gjyqësore, administrative dhe të tjera sipas nevojës,
- Asiston në takime me punëdhënësin,
- Kryen shërbime të tjera profesionale nga lëmia e marrëdhënies së punës,

Kualifikimet e nevojshme për pozitën :

- Kandidati duhet të ketë kryer Fakultetin Juridik,
- Është e preferuar të ketë përvojë profesionale,
- Shkathtësi të mirë të menaxhimit të kohës, detyra dhe shkathtësi komunikative.
- Ai/Ajo duhet të jetë në gjendje që të punojë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe të ketë shkallë të lartë të integritetit. Afinitet për punë në administratë është i dëshirueshëm.
- Shkathtësitë e punës me kompjuter duke përfshirë programet përpunuese Word, Excel, Internet Explorer etj.
- Të ketë njohuri në kontabilitet dhe financa,
- Përparësi njohje e rrjedhshme të gjuhëve: shqipe, anglisht ose serb-kroate.

Të gjithë të interesuarit duhet të dërgojnë CV-it me fotografi dhe me dokumentacionin përcjellës deri me datë 26.012.2019 ora 15:00, në zyrën Qendrore të FSSHK-së me adresë: Rr.Mustaf Kruja Z4-S3, Kati-5 Nr.17 ose në e-mail: info@fsshk.eu. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të kontaktohen për intervistë.



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" SH.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit të datës 31.10.2019 për shpalljen e konkursit, dhe gjendjes momentale, nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeqare, K.R.M. "Uniteti" Sh.A vendosi që më datë 12.12.2019 të shpallë:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendit të punës:

Faturist/e me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeqare), me mundësi vazhdimi

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Bënë llogaritjen dhe shtypjen e faturave sipas shenimeve dhe çmimeve valide të sektorit të amvisërisë dhe sektorit komercial.
- Mban evidencën mbi ndryshimet dhe specifikacionet nga fushëveprimtaria e punëve dhe detyrave të punës, si dhe dëshminë mbi dorëzimin e faturave manipulante për procedurë të mëtejme (Dergimin e fakturave blerësve),
- Regjistron, udhëheq analitiken e blerësve nga arka në terene (inkasantave) dhe ekstraktet bankare, kryen edhe punë tjera sipas urdhërit të cprorit të drejtëpërdrejtë.

Kualifikimet e kërkuara:

- Të ketë diplomën e shkollës së mesme
- Të prezantoj leternjoftimin
- Çertifikatë nga gjykata se nuk jeni i/e denuar (më e re se 6 muaj)
- Cv-në

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj. mundë të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në Kompaninë Regjionale të Mbeturave "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë. Konkursi do të jetë i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 12.12.2019 deri më datën 27.12.2019. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.



**MILLENNIUM
FOUNDATION
KOSOVO**

December 11, 2019

NOTIFICATION OF THE CANCELLATION OF THE PROCUREMENT The Implementation of the Women in Energy (WE) – Internship and Scholarship program

Ref No: MFK /2019/ CQS / No. 012

Following the Millennium Challenge Corporation Program Procurement Guidelines and related request for consultants' qualifications, Millennium Foundation of Kosovo (MFK) hereby notifies that the Procurement "The Implementation of the Women in Energy (WE) – Internship and Scholarship program, with Ref No: MFK /2019/ CQS / No. 012" has been canceled.

This procurement has been cancelled due to appeal decision which requires the cancellation.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Albert Zeqir Shaqiri shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "Naim Frashëri" Prishtinë, Klasa I, II, III, IV dhe V (Librezat).

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkudjesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesë me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

▶ Lëshoj banesë me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Lëshoj banesë me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

▶ Lëshoj banesë e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

▶ Lëshoj banesë një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

▶ Lëshoj me qira banesë e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

▶ Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.

▶ Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

SIGMA



VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. DEGA KOSOVË

NJOFTIM PËR ZHVENDOSJE TË ZYRËS

Të nderuar klientë dhe palë të interesuara,
Ju njoftojmë se Zyra Qendrore e kompanisë së sigurimeve Sigma Interalbani Vienna Insurance Group Sh.A. Dega Kosovë do të zhvendoset në adresën e re, që është:

• Aktash, Rr. Edmond Hoxha nr. 27 (afër udhëkryqit tek menza e studentëve), Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

Data e planifikuar/propozuar dhe për zhvendosjen e zyrës qendrore është 23.12.2019.

Ne do të vazhdojmë të jemi në dispozicionin tuaj për t'ju ofruar shërbimet e kompanisë tonë të sigurimeve në adresën e re të lartshënuar të Zyrës Qendrore.

Ju faleminderit për mirëkuptimin dhe ju mirëpresim në zyrat e reja!

NOTICE FOR OFFICE TRANSFER

Dear clients and interested parties,
We inform you that the Head Office of insurance company Sigma Interalbani Vienna Insurance Group Sh.A. Kosovo Branch will move to the new address, that is:

• Aktash, Edmond Hoxha Str. No. 27 (near the crossroads of the student mess canteen), Prishtina 10000, Republic of Kosova

The planned/proposed date for the Head Office transfer is 23.12.2019.

We will continue to be at your disposal to offer our insurance company's services at the above new Head Office address.

Thank you for your understanding and welcome to the new offices!

OBAVIJEST O ZAMJENI KANCELARIJE

Dragi klijenti i zainteresovane strane,
Obaveštavamo vas da će glavno sedište osiguravajućeg društva Sigma Interalbani Vienna Insurance Group Sh.A. Filijala Kosova preseliti na novu adresu, a to je:

• Aktash, Ul. Edmond Hoxha br. 27 (blizu raskrsnice studentske menze), Priština 10000, Republika Kosova

Planirani/predložni datum preseljenja kancelarije na novu adresu glavnog sedišta je 23.12.2019.

Me čemo i dalje biti na vašem raspolaganju da vam pružimo usluge našeg osiguravajućeg društva na gore navedenu novu adresu glavne kancelarije.

Hvala vam na razumevanju i dobrodošli u nove kancelarije!



SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. - DEGA KOSOVË

Qyteza Pejton, Rr. Ukshin Hoti Nr.13, Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel.+381 38 246 301, Fax. +381 38 246 302 www.sigma-ks.net info@sigma-ks.net